

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6857  
E premte, 24 mars 2023  
çmimi 0.40 €

ZRRE-ja vendos  
që rryma të shtrenjtohet  
për 14 për qind FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRIT ALBIN KURTI KA RAPORTUAR TË ENJTEN NË KUVENDIN E KOSOVËS  
LIDHUR ME TAKIMIN NË OHËR NË KUADËR TË DIALOGUT KOSOVË - SERBI

## KURTI THOTË KA ASOCIACION, OPOZITA E KRITIKON PËR MARRËVESHJEN E OHRIT FAQE 4-5



Kryeministrin Albin Kurti ka pranuar më në fund se në kuadër të marrëveshjes së arritur në Ohër me kryeministrin serb Aleksandër Vuçiq është edhe Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe.

Gjatë raportimit në Kuvendin e Kosovës lidhur me takimin në Ohër në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi, Kurti ka theksuar se procesi i ri ka sjellë një marrëveshje të re dhe është

plotësisht i bindur se sjell një hapje të re drejt rezultatit përfundimtar. Partitë opozitare e kanë akuzuar Kurtin se ka pranuar një marrëveshje të dëmshme për shtetin e Kosovës

### AKTUALE



BE-ja MIRATON EDHE NJË  
PLAN MBËSHTETJEJE  
USHTARAKE PËR UKRAINËN F. 2

LIBE MIRATON PËRFUNDIMISHT  
LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR  
KOSOVËN F. 3

KUVENDI MIRATON  
TRI MARRËVESHJE  
NDËRKOMBËTARE F. 7

### EKONOMI



LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT:  
NË LETËR A NË PRAKTIKË? F. 8

KEDS-I GJATË MUAJIT MARS  
ZURI MBI 500 KONSUMATORË  
DUKE E KEQPËRDORUR ENERGIJËN  
ELEKTRIKE F. 8

### SPORT



ADEMIT I CAKTOHET MASA  
E ARRESTIT SHTËPIAK  
PREJ 30 DITËSH F. 10

DYVJETORI I  
QEVERISË KURTI,  
HARADINAJ: KURTI  
ISHTE NË LUFTË  
ME TË GJITHË,  
PËRFUNDOI NË  
LUFTË ME VETVETEN FAQE 7



BORRELLI:  
ÇDO PËRPPJEKJE  
PËR TA VËNË  
NË PIKËPYETJE  
MARRËVESHJEN  
ËSHTË E KOTË FAQE 6



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## BE-ja miraton edhe një plan mbështetjeje ushtarake për Ukrainën

**BRUKSEL, 23 MARS** - Udhëheqësit e BE-së do të miratojnë një marrëveshje që synon t'i dërgojë Ukrainës 1 milion predha artilerie brenda 12 muajve të ardhshëm për të ndihmuar vendin të mbrohet kundër forcave ruse. Procedura e shpejtë u miratua gjatë një takimi të ministrave të Jashtëm dhe të Mbrojtjes në fillim të kësaj jave dhe krerët e mbledhur në një samit në Bruksel të enjten do t'i japin asaj një bekim politik, sipas disa diplomatëve të lartë të BE-së. Me Ukrainën që po përballet me mungesë municionesh për ta luftuar Rusinë, ideja e krijimit të një plani veprimi të përbashkët blerjeje, të

ngjashëm me atë të krijuar gjatë pandemisë së koronavirusit për të blerë vaksina, u soll për herë të parë në tryezë muajin e kaluar nga kryeministrja e Estonisë, Kaja Kallas. Shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, tha se ai ka fituar miratimin për propozimin e tij për të ofruar 1 miliard euro për t'i inkurajuar vendet anëtare që të ofrojnë predha artilerie nga rezervat e tyre. Nga 27 vendet e BE-së, Hungaria është e vetmja që ka njoftuar se nuk do të marrë pjesë në furnizimin me municion për Ukrainën, duke përmendur angazhimin e saj për paqen, por tha se nuk do t'i



pengojë anëtarët e tjerë ta bëjnë një gjë të tillë. Muajin e kaluar, kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, tha se blloku është pjesërisht fajtor për zgjatjen e luftës së Rusisë në

Ukrainë për shkak të sanksioneve që i kanë vënë Rusisë dhe duke furnizuar Ukrainën me para dhe armë në vend se të kërkojë të negociojë për paqen me Moskën.

Sipas vlerësimeve të ndryshme, Ukraina po gjuan 6 000-7 000 predha artilerie çdo ditë, rreth një e treta e totalit të Rusisë, një vit pas luftës. Udhëheqësit do të diskutojnë edhe për mundësinë e plotësimit me 3.5 miliardë euro shtesë të Facilitetit Evropian të Paqes - një fond që përdoret për t'i rimbursuar vendet anëtare që ofrojnë armë, municion dhe mbështetje ushtarake për Ukrainën. Në takimin e tyre dyditor, udhëheqësve do t'u bashkohet sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, ndërsa presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky do t'i drejtohet takimit me videolidhje.

## Vazhdojnë protestat dhe grevat kundër reformës në pensione në Francë

**PARIS, 23 MARS** - Qindra mijëra njerëz kanë vendosur t'i vazhdojnë grevat dhe protestat në Francë të enjten pasi presidenti Emmanuel Macron u zotua ta çojë përpara planin e tij për reformën e pensioneve pavarësisht prej përshkallëzimit të zemërimit në të gjithë vendin. Protestat kundër legjislacionit, i cili rrit moshën e daljes në pension për dy vjet, kanë tërhequr turma të mëdha në protesta të organizuara nga sindikatat që nga janari. Sindikatat e punëtorëve thanë se dita e nëntë e veprimit mbarëkombëtar të së enjtes do të tërheqë turma të mëdha kundër atyre që ata i përshkruajnë si "përbuzje" dhe "gënjeshtër" të presidentit Macron. Macron ngjalli zemërim të sindikatave dhe partitë opozitare të mërkurën kur hodhi poshtë thirrjet e tyre që ai t'i merrte parasysh kërkesat për të mos e çuar përpara këtë plan. "Përgjigjja më e mirë që mund t'i japim presidentit është se ka miliona njerëz në grevë dhe në rrugë", ka



thënë Philippe Martinez, i cili drejton sindikatat. Shumica e protestave kanë qenë paqësore, por zemërimi është rritur qëkur qeveria e shtyu projektligjin në parlament pa votim, javën e kaluar. Në shtatë netët e fundit në Paris dhe qytete të tjera protestat u

përshkallëzuan me protestues që ua vunë zjarr kazanëve të mbeturinave dhe u përleshën me policinë. Duke folur të mërkurën, Macroni tha se ligji i ri është i nevojshëm dhe do të hyjë në fuqi më vonë këtë vit. Ai tha se është i bindur që reforma është e domosdoshme

në mënyrë që sistemi i pensioneve të mbetet funksional. "Reforma nuk është luks, nuk është për argëtim, është domosdoshmëri për shtetin", tha ai. Macroni i "dënoi" protestat e dhunshme dhe insistoi se "i respekton" sindikatat dhe

protestat që janë organizuar nga kundërshtarët e tij, të cilët nuk pajtohen me planin për pensione. Sindikatat kanë bërë thirrje për protesta mbarëkombëtare të enjten dhe për greva në sektorët kyçë derisa qeveria ta tërheqë këtë projektligj.

## ShBA-ja rrit sërish normën e interesit

**WASHINGTON, 23 MARS** - Banka Qendrore e Shteteve të Bashkuara e ka rritur sërish normën e interesit pavarësisht prej shqetësimeve se një hap i tillë mund ta përkeqësojë gjendjen aktuale financiare. Vetëm këtë muaj është raportuar për falimentim të disa bankave në ShBA. Rezervat Federale e kanë rritur normën e interesit për 0.25 për

qind dhe kanë thënë se ky veprim mund të jetë "i duhuri" pas rritjes së çmimeve të konsumit. Përmes një deklarate, Rezervat Federale kanë thënë se sistemi bankar amerikan është "i qëndrueshëm", mirëpo rritja e shpejtë e normave të interesit e ka rënduar sistemin bankar. Dy banka amerikane - Silicon Valley dhe Signature - kanë

falimentuar këtë muaj, kryesisht për shkak të problemeve të shkaktuara nga rritja e normave të interesit. Mirëpo autoritetet në gjithë botën kanë thënë se nuk mendojnë që falimentimi i këtyre dy bankave kërcënon zgjerimin e krizës edhe në institucionet e tjera bankare. Javën e kaluar edhe Banka Qendrore Evropiane e ka rritur normën e interesit për 0.5 për qind.





## LIBE përfundimisht miraton liberalizimin e vizave për Kosovën

PRISHTINË, 23 MARS - Komisioni për Liritë Qytetare, Punë të Brendshme dhe Drejtësi (LIBE) i Parlamentit Evropian ka miratuar edhe një herë vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, pasi një gjë të tillë, para disa javësh, e kishin miratuar edhe ministrat e Brendshëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Ky vendim ka marrë shumicën e nevojshme në këtë komision parlamentar me 47 vota për, 8 kundër dhe 4

abstenime. Në muajin prill, eventualisht në maj, pritet të miratohet edhe në seancë plenare të Parlamentit Evropian. Pas kësaj, vendimi do të nënshkruhet dhe botohet në gazetën zyrtare të Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë do të përmbyllet i tërë procesi formal. Nuk ka pasur asnjë ndryshim në tekstin e vendimit. Pra, sipas asaj që ishin marrë vesh qysh në vitin e kaluar

përfaqësuesit e vendeve anëtare të BE-së, ky vendim do të hyjë në fuqi në kohën kur të hyjë në fuqi sistemi evropian i regjistrimit dhe autorizimit të udhëtimit (ETIAS), por jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024. Pasi afati për hyrje në fuqi të ETIAS-is është shtyrë për vitin 2024, dita e parë e këtij viti, pra 1 janari i vitit 2024, realisht pritet të jetë edhe dita prej së cilës qytetarët e Kosovës do të mund të lëvizin pa viza në



vendet e zonës Schengen. Kjo zonë përfshin pothuajse të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian, por edhe

vendet si Zvicra, Norvegjia, Islanda e Lihtenshtajni që nuk janë në BE, por janë pjesë e zonës së lëvizjes së lirë.

## ZRRE-ja vendos që rryma të shtrenjtohet për 14 për qind

- Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) kërkon nga qytetarët që në mënyrë të organizuar ta kundërshtojnë shtrenjtimitin e rrymës

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 MARS - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) në mbledhjen e fundit ka miratuar tarifën e reja për energjinë elektrike. Duke filluar nga 1 prilli, rryma do të shtrenjtohet për 14 për qind bazuar në këto tarifa. Sipas ZRRE-së, kjo rritje ka ardhur për arsye se ende çmimet e importit për energji mbesin të larta. "Drafti për rritje është rreth 14 për qind, mirëpo ende nuk është bërë vendim. Pritet që brenda këtij muaji të shndërrohet në vendim. Kështu që propozimi nga ana e stafit është rreth 14 për qind. Ne duhet edhe një herë t'i shqyrtojmë komentet. Pasi t'i shqyrtojmë dalim me përgjigje ndaj këtyre komenteve me një raport final, pastaj shndërrohet në vendim", ka deklaruar kryesuesi i ZRRE-së, Ymer Fejzullahu, duke shtuar se janë në pritje të komenteve nga institucionet dhe organizatat relevante me qëllim që të merret vendimi.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar nga qytetarët që në mënyrë të organizuar ta kundërshtojnë shtrenjtimitin e rrymës. "Qytetarët e Kosovës me të drejtë të pakënaqur me këtë paralajmërim të shtrenjtimit të rrymës e që do të



përcillet nga ngritja zinxhirore e çmimeve të artikujve të tjerë dhe të shërbimeve nuk duhet të ndalen vetëm me një reagim të çastit në KMDLNj apo tek Avokati i Popullit, por duhet të organizohen përmes aktivizimit qytetar në mbrojtje të interesave të tyre, aq më parë që kategoritë e cenueshme, pensionistët, përfuturit e skemave pensionale, veteranët dhe invalidët e luftës, viktimat e dhunës seksuale gjatë

luftës që nga fillimi i zbatimit për përkrahje financiare, kompensimet apo lëmoshat sociale që i marrin, nuk janë rritur aspak, ndërkohë që çmimet kanë shkuar në qiell", thuhet në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj ka njoftuar se e ka kundërshtuar dhe vazhdon ta kundërshtojë shtrenjtimitin e rrymës i cili prodhon një proces zinxhir të shtrenjtimit dhe pret që qytetarët ta kundërshtojnë

edhe me protesta dhe jo vetëm në mënyrë deklarative. "Deputetët, si përfaqësues të popullit nga edhe e kërkojnë votën dhe e fitojnë të drejtën e përfaqësimit, tash për të gjithë qytetarët e Kosovës, duhet ta kundërshtojnë këtë shtrenjtimit, qoftë në kuadër të komisioneve përkatëse të Kuvendit ashtu edhe në seancat parlamentare, pa bërë dallime partiake dhe pa u përpjekur ta kapitalizojnë këtë kundërshtim politikisht", është

thënë në reagimin e KMDLNj-së. ZRRE-ja bën shqyrtimin dhe caktimin e tarifave çdo vit. Tarifat aktuale për konsumatorët që shpenzojnë mbi 800 kilovatë në orë brenda një muaji paguajnë 12.5 centë për kilovat gjatë tarifave të shtrenjta, ndërsa 5.9 centë gjatë tarifave të ulëta. Konsumatorët që shpenzojnë më pak paguajnë 7 centë për kilovat gjatë tarifave të shtrenjta dhe 3 centë gjatë tarifave të lira.

## "Edhe asi, edhe ksi", PSD-ja ngjyros veturën e kryeparlamentarit Konjufca

PRISHTINË, 23 MARS - Partia Socialdemokrate ka realizuar të enjten një aksion simbolik, duke shkruar në veturën e kryeparlamentarit Glauk Konjufca "edhe asi, edhe ksi". Aksioni i PSD-së është realizuar para ndërtesës së Kuvendit të Kosovës. "Ky është Glauku i shpërfytyruar. 'Edhe ksi, edhe asi': kjo është parulla që kemi shkruar në

njërin nga xhipat e Glauk Konjufcës. Kështu lexohen qëndrimet e tij. Pasi ta dëgjosh deklarimin, përmbysë atë dhe kështu del e vërteta e tij. Ky është Glauku i shpërfytyruar", është bërë me dije në njoftimin e PSD-së. PSD-ja, parti e cila drejtohet nga Dardan Molliqaj, këto ditë ka zhvilluar aksione simbolike në disa komuna, duke

shprehur kundërshtimin ndaj marrëveshjes së arritur në Ohër në mes të Kosovës dhe Serbisë, ku pjesë e zotimit është edhe themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. PSD-ja ka paralajmëruar protestë më 25 mars në orën 14:00 në sheshin "Zahir Pajaziti", në të cilën do ta kërkojë dorëheqjen e Kurtit.







KRYEMINISTRIT ALBIN KURTI KA RAPORTUAR TË ENJTEN NË KUVENDIN E KOSOVËS LIDHUR ME TAKIMIN NË OHËR NË KUADËR TË DIALOGUT KOSOVË - SERBI

# Kurti thotë ka Asociacion, opozita e kritikon për marrëveshjen e Ohrit

Kryeministri Albin Kurti ka pranuar më në fund se në kuadër të marrëveshjes së arritur në Ohër me kryeministrin serb Aleksandër Vuçiq është edhe Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Gjatë raportimit në Kuvendin e Kosovës lidhur me takimin në Ohër në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi, Kurti ka theksuar se procesi i ri ka sjellë një marrëveshje të re dhe është plotësisht i bindur se sjell një hapje të re drejt rezultatit përfundimtar. Partitë opozitare e kanë akuzuar Kurtin se ka pranuar një marrëveshje të dëmshme për shtetin e Kosovës

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 23 MARS** - Kryeministri Albin Kurti ka raportuar të enjten në Kuvendin e Kosovës lidhur me takimin e nivelit të lartë politik në Ohër në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi. Në marrëveshjen e arritur më 18 mars në Ohër, specifikohet se të dyja shtetet duhet t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në të kaluarën. Kjo përfshin edhe themelimin e një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe, marrëveshja për të cilën u arrit në vitin 2013 dhe u specifikua në vitin 2015.

Një deklaratë e Kurtit dhënë në televizionin publik të Kosovës, ku pranon se pjesë e marrëveshjes është edhe Asociacioni, ka ngjallur debat në vend nga opozita dhe shoqëria civile. "Ka Asociacion, neni 10, thotë se të dyja palët e konfirmojnë obligimin e tyre për t'i zbatuar marrëveshjet e kaluara për të cilat ngelen valide dhe të obligueshme", është shprehur kryeministri. Kurti të enjten para deputetëve ka thënë se procesi i ri ka sjellë një marrëveshje të re dhe është plotësisht i bindur se sjell një hapje të re drejt rezultatit përfundimtar. Kurti e quajti këtë marrëveshje "tekstin më të

mirë që ka mundur të arrihet tani për tani". "Marrëveshja Bazë për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmban vetëm 11 nene dhe një preambulë dhe aneksi shton 12 pika të tjera. Ia vlen të mundimi pasi arritëm diçka të rëndësishme dhe të pakthyeshme", ka thënë Kurti. Kurti ka theksuar para deputetëve se Marrëveshja Bazë konfirmon se marrëdhëniet ndërkombëtare të Kosovës zhvillohen në bazë të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të gjitha të drejtave themelore që

karacterizojnë një shtet të konsoliduar ndërkombëtarisht dhe sovran e me integritet territorial. "Serbia ka pranuar ta trajtojë Kosovën si anëtare të barabartë të bashkësisë ndërkombëtare. Me marrëveshjen, Serbia është zotuar të mos kërcënojë më përdorimin e forcës dhe t'u japë fund mosmarrëveshjeve me mjete paqësore. Ajo e ka pranuar këtë, megjithëse ende nuk do t'i besojë plotësisht Serbisë për këtë. Ajo nuk mund të pretendojë se përfaqëson ndërkombëtarisht shtetin tonë, apo atë që ndodh brenda territorit tonë. Ajo e ka pranuar këtë rregull sjelljeje. Ne të dy do të duhej të jemi të përkushtuar të zhvillojmë marrëdhënie normale, të fqinjësisë së mirë me njëri-tjetrin, siç thuhet qartë, saktë, tekstualisht në marrëveshje", ka thënë Kurti. Kurti ka theksuar se për më tepër, Serbia duhet të mos kundërshtojë më anëtarësimin në asnjë organizatë

ndërkombëtare, apo ta bllokojë rrugën e Kosovës drejt integritit në Bashkimin Evropian. "Duhet të ketë njohje reciproke të dokumenteve dhe simboleve shtetërore përkatëse, duke përfshirë pasaportat, diplomat, targat dhe vulat doganore. Do të shkëmbejmë edhe misione të përhershme, në thelb ambasadat me një emër tjetër. Serbia i ka pranuar të gjitha këto më sipër. Kjo natyrisht që është njohje de facto, e vendosur në formë të shkruar dhe me një status të pakthyer tashmë sepse Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë garantorë për përhershmerinë e saj kohore", është shprehur kryeministri. Kurti ka thënë se nuk mund të ketë zbatime të njëanshme të marrëveshjes siç nuk mund të ketë as nënshkrim të njëanshëm të marrëveshjes. "Kosova i ka obligimet e veta ligjore. Unë personalisht kam



kundërshtuar disa nga marrëveshjet në të kaluarën dhe vazhdoj të punoj për një rezultat më të mirë, shumë më të mirë. Sepse Kosova meriton dhe i takon shumë më tepër. Në të njëjtën kohë, aleatët tanë na kujtojnë se marrëveshjet janë arritur ndërmjet qeverive në emër të shteteve tona me detyrime të qëndrueshme edhe kur qeveritë ndryshojnë. Nëse duam të trajtohem si shtet dhe të njihemi si një i tillë, unë nuk mund t'i shmang detyrimet nga traktatet ndërkombëtare që ne lidhim. Por, në të njëjtën kohë, jam i bindur që tekst më të mirë të marrëveshjes në situatën që jemi nuk ka qenë e mundur të mbërrijmë. Megjithatë, ato detyrime nga e kaluara janë edhe të përfshira implicit në procesin e dialogut sepse janë ngritur gjatë bisedimeve dhe çdo gjë ne do ta konsiderojmë nga prizma e Kushtetutës sonë, e Republikës sonë, e ligjshmërisë sonë dhe e vlerave, e kartave normative, ndërkombëtare në veçanti evropiane”, ka deklaruar Kurti. Ai iu përgjigj kritikave të opozitës në lidhje me pikën 7 të kësaj marrëveshjeje që parasheh “sigurimin e një niveli të përshtatshëm të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë” “Vetëmenaxhimi nuk është as vetëqeverisje as vetëadministrim”, tha Kurti duke u kërkuar deputetëve opozitarë që të mos përdorin “nacion të skajshme”. Më tutje, Kurti ritheksoi se do të angazhohet që nuk do të ketë

një pushtet ekzekutiv në mes të nivelit qendror e lokal në Kosovë përmes këtij asociacioni. “Ne bëmë maksimumin për ta përmirësuar situatën dhe ia dolëm që të sigurojmë më shumë hapësirë për ecjen përpara. U bë plotësisht e qartë nga lehtësuesi apo ndërmjetësuesi i BE-së dhe nga partnerët tanë amerikanë, se Kosova nuk do të rëndohet me kurrfarë shtrese tjetër të autoritetit ndërmjet komunave dhe Qeverisë së Kosovës dhe nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do të largohet nga kufizimet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese dhe kjo është bërë edhe gjatë procesit të dialogut edhe në deklarimet publike. Pra ka dalë qëndrimi i drejtë i kritikës sonë ndaj çfarëdo qëllimi, synimi, kërkesë të Serbisë që, fatkeqësisht, në të kaluarën edhe janë pranuar në Kosovë”, është shprehur Kurti. Ai ka theksuar se nuk ka ndër mend të kritikojë gjerë e gjatë tash për marrëveshjet e para tetë apo dhjetë vjetëve për këto vendime të kaluara të cilat janë aty, janë në arkivat e Brukselit, janë në arkivat edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës pasi, sipas tij, duhet të shkojmë përtej kësaj duke qenë se është interes yni shtetëror e kombëtar që duhet të na shohë duke punuar së bashku. “Tani kemi një dokument të ri në dorë dhe duhet ta shfrytëzojmë sa më mirë. E kemi një dokument të ri çfarë ka qenë i paparë e i paarritshëm më

herët dhe kjo është edhe armë e fuqishme për ne për të ecur përpara”, ka thënë Kurti, duke shtuar se ai kurrë nuk do të konsiderojë asnjë model të autonomisë territoriale. “Megjithëse marrëveshjet e mëhershme të Brukselit janë mbështetur shumë në territorialitetin si element qendror”, u është përgjigjur Kurti opozitës. Ai i ka ftuar deputetët e opozitës të jenë bashkë në këtë proces. “Tash duhet të kalojmë bashkërisht dhe unë ju ftoj të gjithëve, si deputetë të Kuvendit të Republikës, që të kalojmë bashkërisht nga standardet e Daçiqit e të Vuçiqit në vitet 2013 dhe 2015, në ato të Këshillit të Evropës e sistemit demokratik të Bashkimit Evropian të bazuar në qytetarin. Qytetari është thelbi, jo territori, jo etnonacionalizmi territorial, i cili ndan, përçan e segregon, por përkundrazi qytetari, i cili është i Republikës, pavarësisht përkatësisë, pavarësisht identitetit me të drejta dhe me të drejta për kërkesa, por gjithnjë brenda Kushtetutës republikane”, është shprehur Kurti.

### Opozita me kritika për “transformimin e Kurtit” karshi Asociacionit

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, e kritikoi Kurtin për zbrapsje nga qëndrimet e tij, sidomos sa i përket Asociacionit.

“Kryeministri i Kosovës me një fjali mbrëmë e ka përmbysur të gjithë jetën e tij politike. Po, ka Asociacion dhe ka pasur Asociacion sa herë që ky ka thënë që nuk ka Asociacion”, ka deklaruar Krasniqi. Sipas Krasniqit, me marrëveshjen në Ohër Kurti “ka rrezikuar t’u japë autonomi politike serbëve të Kosovës”.

Edhe Lumir Abdixhiku, kryetar i partisë opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës, e kritikoi Kurtin në lidhje me pranimin e Asociacionit në marrëveshjen e Ohrit pa i përfillur kushtet e tij që i kishte vënë në fillim të muajit shkurt. Një ndër kushtet që e përmendura nga Kurti ishte që Asociacioni të jetë pjesë e marrëveshjes finale dhe të zbatohet vetëm pas njohjes reciproke. “Të 6 kushtet e kryeministrit rreth formimit të Asociacionit të bëra publike në seancën e 2 shkurtit 2023 u zhbënë fillimisht me marrëveshjen e 27 shkurtit e më pas, përfundimisht, në aneks-marrëveshjen e Ohrit. Asociacioni është pjesë e marrëveshjes finale dhe zbatohet pas njohjes reciproke’ ishte një ndër kushtet e Kurtit në këtë Kuvend. Nuk kanë kaluar as 2 muaj dhe aneks-marrëveshja e pranuar në formë deklarative në Ohër parasheh qartë obligimin e palëve për t’i nisur menjëherë diskutimet e themelimit të aranzhimeve speciale për vetëmenaxhimin e komunitetit serb në Kosovë sipas marrëveshjeve paraprake

në një marrëveshje pa njohje në të. Ndiej keqardhje për të mashtruarit, të përdorurit, të shfrytëzuarit dhe për humbjen e kohës së Republikës së Kosovës”, ka thënë Abdixhiku. Në anën tjetër, shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka thënë se me marrëveshjen e Ohrit dialogu dhe diskutimi me Bashkimin Evropian do të vazhdojë me vite. “Për ne kjo duhet të përdoret si mundësi e forcimit të shtetit të Kosovës, por është edhe një potencial për gabime dhe lëshime”, është shprehur Tahiri, i cili ka sugjeruar që në komitetin që monitoron zbatimin e marrëveshjeve të përfshihen edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Marrëveshja, prej 11 nenesh, nuk përmend në mënyrë specifike njohjen e ndërsjellë. Megjithatë, dokumenti kërkon nga të dyja vendet t’i pranohet dokumentet dhe simbolet e njera-tjetrës, përfshirë pasaportat, diplomat dhe targat. Dokumenti kërkon nga palët t’i zbatohet të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilin Qeveria në Prishtinë e ka refuzuar deri më tash me arsyetimin se mund ta rrezikojë funksionalitetin e shtetit.





# Borrelli: Çdo përpjekje për ta vënë në pikëpyetje marrëveshjen është e kotë



“Çdo përpjekje për ta vënë në pikëpyetje marrëveshjen është e kotë. Marrëveshja është arritur. Duhet të zbatohet dhe nuk ka vend për zgjedhje. Duhet të zbatohet në tërësi. Ne do të monitorojmë me kujdes se kush e zbaton dhe kush nuk e zbaton”, ka thënë shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, duke folur për arritjen e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë në Ohër

**PRISHTINË, 23 MARS** - Shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, ka thënë para fillimit të takimit të liderëve të Bashkimit Evropian, se Kosova dhe Serbia duhet të fokusohen në zbatimin e asaj që është rënë dakord. “Çdo përpjekje për ta vënë në pikëpyetje marrëveshjen është e kotë. Marrëveshja është arritur. Duhet të zbatohet dhe nuk ka vend për zgjedhje. Duhet të zbatohet në tërësi. Ne do të monitorojmë me kujdes se kush e zbaton dhe kush nuk e zbaton”, ka thënë Borrelli.

Pajtimi i arritur në mes të palëve në Ohër të shtunën e shkuar do të jetë pjesë edhe e konkluzave nga

ky takim i liderëve të vendeve anëtare të BE-së. “Këshilli Evropian mirëpret marrëveshjen e arritur në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian për aneksin për implementimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe u bënë ftesë të dyja palëve që në mënyrë të përshtatshme dhe me mirëbesim t’i implementojnë obligimet e tyre përkatëse”, thuhet në këtë tekst.

Për këtë temë ishte diskutuar edhe më herët gjatë javës në takimin e Këshillit të Ministrave të Jashtëm të BE-së. Edhe atyre u kishte raportuar Josep Borrell. Ai

e kishte quajtur si një “status quo të ri” në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, që do ta sigurojë kalimin nga një fazë e krizave, në një fazë të implementimit të marrëveshjes. Shumë shtete të BE-së e kanë mirëpritur marrëveshjen e arritur në Ohër dhe kanë kërkuar që fokusi tani të drejtohet kah implementimi.

Burimet diplomatike në Bruksel kanë thënë se disa shtete kanë ftuar të ketë “kujdes të shtuar” nga ana e BE-së në mënyrë që të sigurohet zbatimi i plotë i të gjitha pikave të marrëveshjes dhe që të mos lejohet devijimi nga obligimet për asnjërën palë. Në strukturat e BE-së pritet të nisnin edhe procedurat që implementimi i marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë të përfshihet edhe formalisht në kornizën e negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE dhe në raportimin e një komisioni të veçantë për normalizim për Kosovën. Në BE kanë përsëritur se, ndonëse nuk është nënshkruar marrëveshja formalisht, për shkaqe ligjore, zbatimi i saj dhe i

aneksit për implementim është detyrim për palët.

## Blinkeni: Zbatimi i marrëveshjes i hap rrugë njohjes së Kosovës nga 5 vendet e BE-së

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se nëse marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë zbatohet, kjo do t’i hapte rrugën njohjes së Kosovës nga pesë vendet e Bashkimit Evropian që nuk e kanë njohur atë.

Sekretari Blinken i bëri komentet në përgjigje të një pyetjeje të senatores demokrate Jeanne Shaheen lidhur me përpjekjet e tij për t’i bindur pesë vendet e BE-së që nuk e njohin Kosovën. “Sigurisht është një çështje që vazhdojmë ta ngremë, por unë mendoj se kjo marrëveshje, nëse ecën përpara, në fakt na vendos në një rrugë drejt njohjes nga këto vende”, ka thënë Blinken.

Ai e pranoi se njohja e Kosovës nga Serbia është tjetër çështje

dhe do të dojë kohë. “Por nëse ato (vendet) arrijnë në një marrëdhënie të normalizuar, kjo do të kishte një efekt pozitiv dhe besoj se me kalimin e kohës do të arrijmë në atë pikë, por mendoj se për pesë vendet që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, fakti që këto vende (Kosova dhe Serbia) kanë arritur marrëveshjen dhe duke supozuar se do ta zbatojnë, kjo do t’i shtyjë ato drejt njohjes”, është shprehur Blinken.

Sekretari i Shtetit, Blinken, tha gjatë seancës se përparimi që është arritur në mes të Serbisë dhe Kosovës është shprehëdhënës, veçanërisht ai i fundjavës së kaluar për ta zbatuar udhërrëfyesin në rrugën drejt normalizimit. “Besoj se ajo që është e rëndësishme, përveç faktit që të dyja vendet kanë rënë dakord në parim që ta bëjnë një gjë të tillë, është që këto angazhime janë pjesë e planeve të të dyja vendeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, prandaj shpresoj se kjo të jetë një nxitje që ato t’i zbatojnë ato”, ka thënë sekretari i Shtetit, Antony Blinken.

## Dy oficerë të FSK-së kryejnë Kursin për Kapiten të Karrierës në Gjermani

**PRISHTINË, 23 MARS** - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka bërë me dije se Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) po i shtohen çdo ditë e më shumë kadro të reja profesionale.

Mehaj në “Facebook” ka shkruar se dy oficerë të FSK-së kanë përfunduar me

sukses Kursin për Kapiten të Karrierës në shkollën e Oficerëve të Këmbëtorisë në Republikën Federale të Gjermanisë. “Forcës së Sigurisë së Kosovës çdo ditë e më shumë po i shtohen kadro të reja profesionale. Oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, toger Valdet

Halimi dhe toger Granit Revuçi, përfunduan me sukses Kursin për Kapiten të Karrierës në shkollën e Oficerëve të Këmbëtorisë në Republikën Federale të Gjermanisë. Diplomimi i tyre është vlerë e shtuar për ushtrinë tonë!”, ka shkruar Mehaj.





## Preteni: Jam shumë kureshtar të di pse jam në listën e zezë të kryeministrit Kurti

PRISHTINË, 23 MARS - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të fundit ka emëruar edhe Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike "Infrakos". Kryesuese e këtij Bordi është zgjedhur Edona Nahi. Lidhur me këtë ka reaguar ish-drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Hasan Preteni, i cili thotë se ishte një nga kandidatët për anëtar të

këtij bordi. "Jam shumë kureshtar të kuptoj pse jam në listën e zezë të kryeministrit Kurti. Më eliminoi nga lista për Bordin e NP Bifurkacioni, madje në atë listë kam qenë i pari (vlerësim i komisionit të caktuar nga vetë KM). Ndoshta s'i pëlqeva kur më thirri për takim në zyrën e tij (në muajin gusht, ditë e shtunë). Tani në

konkurrencën e 23 kandidatëve për drejtor në Bordin e NP 'Infrakos', në mesin e gjashtë më të vlerësuarit unë u rendita i dyti, kryeministri vendosi që kandidati i renditur në vendin e 6 të emërohet kryesuese e Bordit, kurse për mua nuk pati fare vend në Bord! Cila është arsyeja, z. kryeministër?", ka shkruar Preteni në "Facebook".



## Dyvjeteri i qeverisë Kurti, Haradinaj: Kurti ishte në luftë me të gjithë, përfundoi në luftë me vetveten

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 MARS - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka mbajtur të enjten një konferencë për medie në dyvjeterin e qeverisë Kurti. Ai ka thënë se qeveria Kurti ishte në luftë me të gjithë, por në fund përfundoi në luftë me vetveten. Haradinaj ka theksuar se Kurti u shpalli luftë kategorive të lirisë, të punësuarve në sektorin publik, atyre në sektorin privat, sipërmarrësve, komuniteteve etnike dhe aleatëve ndërkombëtarë, raporton "Epoka e re". "Jemi në dy vjet të qeverisjes Kurti. Ai ishte në luftë me të gjithë, por përfundoi në luftë me vetveten. Pra, Kurti u shpalli luftë të gjithëve, si fillim kategorive të lirisë, duke mos i përkrahur në pagën minimale. U shpalli luftë të punësuarve në sektorin publik duke mos i përkrahur me rritje të pagave. U shpalli luftë të gjithë sipërmarrësve duke mbajtur peng buxhetin e Kosovës dhe duke ndaluar investimet kapitale. Gjithashtu, u shpalli luftë të punësuarve në sektorin privat dhe të papunëve. Vazhdoi duke u

shpallur luftë komuniteteve etnike në Kosovë dhe aleatëve tanë. Rezultati i kësaj qeverisje ka prodhuar lodhje, jo vetëm që është lodhur qytetari i vendit, por ka arritur t'i lodhë edhe aleatët tanë, edhe ata më besnikë si ShBA-ja, që nuk pranoi për një vit zyrtarë të kësaj qeverie në Uashington", ka thënë Haradinaj. Ai ka theksuar se në ditën e sotme situata në vend është jashtëzakonisht serioze dhe, sipas Haradinajt, qeveria Kurti nuk duhet të bëjë eksperimente në obligimet që ka marrë për ta implementuar marrëveshjen e njohur si franko-gjermane, por që është amerikane. "Besoj se improvizimet në implementim do t'i thellojnë edhe më shumë pasojat që tashmë i ndiejmë si Kosovë, izolimin tonë, agjendën ndërkombëtare, po ashtu në planin e sigurisë do të shkaktojnë pasojat, veçanërisht në gjendjen e krijuar në veri të vendit. Pra i bëjmë apel Kurtit dhe qeverisë të jenë seriozë dhe mos të humbin kohë, të mos bëjnë eksperimente, por të veprojnë menjëherë në implementim të marrëveshjes në bazë të obligimeve që ka marrë Kosova", është shprehur lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.



## Kuvendi miraton tri marrëveshje ndërkombëtare



PRISHTINË, 23 MARS - Kuvendi i Kosovës në seancën e së enjtes ka miratuar tri marrëveshje ndërkombëtare. Në këtë seancë parlamentare, 81 deputetë kanë votuar për, nëntë kundër dhe asnjë abstenim për marrëveshjen ndërkombëtare të financimit në mes të Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për "Projektin e reformës së sistemit të ndihmës sociale në Kosovë". Po ashtu, me 88 vota për, asnjë

kundër, asnjë abstenim është votuar edhe marrëveshja e kredisë për projektin-korniza e qyteteve të gjelbra 2 dritarja 2 - eficientia e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë në mes të Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Deputetët kanë miratuar edhe marrëveshjen e tretë me 90 vota për, e cila ka të bëjë me projektin "Eficientia e energjisë në ndërtesa publike në Prizren" ndërmjet Kosovës dhe Bankës

Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka falënderuar deputetët e Kuvendit që mundësuan ratifikimin e tri marrëveshjeve ndërkombëtare përmes të cilave Kosovës i vihen në dispozicion mbi 59 milionë euro për reformimin e skemave sociale dhe për investime në eficientë të energjisë për ndërtesat publike në komunën e Prishtinës dhe atë të Prizrenit.

## Pacolli: Kenia ka vendosur t'i njohë pasaportat e Kosovës

PRISHTINË, 23 MARS - Kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), deputeti Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se Republika e Kenias ka vendosur ta njohë pasaportën e Kosovës. Pacolli këtë lajm e ka bërë me dije në "Facebook", pas takimit me presidentin e Kenias, William

Ruto. "Sot vizitova në Nairobi presidentin e Republikës së Kenias, mikun tim William Ruto, për ta falënderuar për miqësinë e tij ndër vite. Gjatë takimit ai më njoftoi se ka marrë vendim me të cilin Republika e Kenias ka zyrtarizuar fillimin e

bashkëpunimit me Republikën e Kosovës në të gjitha fushat e interesit të përbashkët. Njohja e pasaportës së Republikës së Kosovës është hapi i parë i konkretizimit. Ky është një moment historik për raportet diplomatike të Kosovës me Kenian", ka shkruar Pacolli.





# Lufta kundër korrupsionit: Në letër a në praktikë?



**PRISHTINË, 23 MARS** - Në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë gjatë vitit 2022 janë ngritur 225 raste të reja që lidhen me zyrtarët shtetërorë, apo 120 më shumë se në vitin paraprak, konfirmojnë zyrtarë të kësaj agjencie.

Drejtori Yll Buleshkaj thotë se rastet e ngritura janë përcjellë edhe me opinion formal dhe se shumë prej tyre janë dorëzuar në prokurori. "Shumica nga to ndërlidhen me deklarin e pasurisë qoftë për shkak të vonesës [së deklarin], qoftë për shkak të pasaktësisë në deklarin", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Kosova prej vitësh është në shënjestër të kritikave të institucioneve dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare për, siç thuhet, nivel të lartë korrupsioni.

I fundit ka qenë Departamentit amerikan i Shtetit, i cili, në një raport të publikuar më 20 mars, ka nxjerrë në pah se Kosova ka "korrupsion serioz qeveritar". "Zyrtarët, ndonjëherë, janë të përfshirë në praktika korruptive, pa u ndëshkuar. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe

brishtësia për zbatim të ligjit kanë rezultuar me këtë problem", është thënë në raport.

## Qeveria: Situata nuk është e njëjta siç ka qenë

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, në anën tjetër, thonë se janë mbi 300 zyrtarë publikë që janë arrestuar në dy vjetët e fundit nën dyshimet për korrupsion. "Kjo nuk do të thotë se korrupsioni është eliminuar në tërësi, por besojmë se situata nuk është e njëjta siç ka qenë. Ajo po shkon drejt përmirësimit. Përkushtimi ynë mbetet i njëjtë", thuhet në një deklaratë të ekzekutivit dërguar "Radios Evropa e Lirë".

Qeveria aktuale, e udhëhequr nga Albin Kurti, e ka marrë detyrën saktësisht dy vjet më parë. Në deklaratën dërguar REL-it, ajo thotë se Kosova në raportin e sivjetmë të organizatës ndërkombëtare Transparency International ka shënuar përparim, duke u renditur për 20 pozita më mirë në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë, ky raport ka vlerësuar se Kosova, pavarësisht luftës kundër korrupsionit, nuk e ka ende nën kontroll këtë dukuri.

## Parashkrimi i lëndëve, pa burg efektiv për personat e profilit të lartë

Gëzim Shala nga Instituti i Kosovës për drejtësi thotë se problematike në vend është sidomos dukuria e parashkrimit të lëndëve, apo vjetërsimit të tyre.

Kodi Penal i Kosovës e parasheh mundësinë e parashkrimit të lëndës, e cila, nëse nuk trajtohet brenda afatit të caktuar ligjor, bën që ndjekja penale ndaj personit të caktuar të ndërpritet. "Veçanërisht duhet ta kemi parasysh faktin se në Kosovë nuk ka ende asnjë person të profilit të lartë të dënuar me burgim efektiv për vepra penale të korrupsionit. Kjo mungesë e rezultateve, përfundimisht, e ka shndërruar sistemin e drejtësisë në një sistem pa zotësi, për t'i dhënë përgjigje korrupsionit qeveritar", thotë Shala për "Radion Evropa e Lirë".

Parashkrimi i lëndëve është përmendur si problematikë edhe në raportin e Departamentit amerikan të Shtetit. Sipas tij, Instituti i Kosovës për Drejtësi, në dhjetor të vitit 2021, ka identifikuar 11 raste të korrupsionit që kanë rrezikuar

parashkrim. Në janar të vitit 2022 "shtatë nga këto raste kanë skaduar për shkak të parashkrimit".

Shala thotë se ndodh shpesh që zyrtarë të ndryshëm "një pjesë të ditës e kalojnë duke u përballur me aktakuza në gjykatë", ndërsa pjesën tjetër në pozita publike. "Kjo, të paktën, lë shije të keqe në publik. Ne e kemi parasysh prezumimin e pafajësisë dhe kemi parasysh se, jo domosdo, secili që përballlet me aktakuzë, është i fajshëm. Por, në kuptim të mbrojtjes së integritetit të institucionit dhe pastaj edhe të besimit të publikut në një proces gjyqësor të caktuar të njëjtët duhet të lëshojnë rrugë dhe të mos e mbajnë pozitën gjatë kohës kur kanë probleme me ligjin", thotë Shala.

## "Mungojnë rezultatet"

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kur e ka marrë mandatin dy vjet më parë, ka thënë se lufta kundër korrupsionit do të jetë në mesin e prioritetëve kryesorë të qeverisë së tij. Por, sipas Mexhide Demollit nga Lëvizja FOL, që bën fushatë kundër korrupsionit, rezultatet konkrete që e faktojnë luftimin e kësaj dukurie në nivel të lartë, mungojnë. "Nga ajo që kemi

parë deri më tani, asnjë person i profilit të lartë nuk është dënuar me burg efektiv për korrupsion. Prandaj, edhe rrjedh një konkluzion i tillë në raportin e Departamentit amerikan të Shtetit. Jemi mësuar tashmë nga çdo qeveri që ta kemi këtë thënien 'lufta kundër korrupsionit mbetet prioritet'. Mirëpo, kjo ndodh vetëm në letër", thotë Demolli për "Radion Evropa e Lirë".

Ajo pranon se ka nisma të mira legislative nga Qeveria e Kosovës, sikurse vetingu në sistemin e drejtësisë, apo verifikimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, por thotë se procedura për ta shndërruar këtë në ligj është duke shkuar "tejet ngadalë".

Koncept-dokumentin për vetingun në drejtësi Qeveria e Kosovës e ka miratuar në tetor të vitit 2021. Në shtatorin e vitit 2022 dosja e vetingut i është dorëzuar kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ndërsa në shkurt të këtij viti një komision ad-hoc i Kuvendit ka votuar ndryshimet kushtetuese për vetingun.

Një muaj më vonë Konjufca ia ka dërguar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës amendamentet për ta marrë mendimin, por kjo gjykatë nuk ka dalë ende me vendim.

## KEDS-i gjatë muajit mars zuri mbi 500 konsumatorë duke e keqpërdorur energjinë elektrike

**PRISHTINË, 23 MARS** - Planet dhe aksionet për kontroll të keqpërdorimeve të ekipeve të Departamentit të Humbjeve në KEDS vazhdojnë të zbatohen në tërë Kosovën. KEDS-i ka njoftuar se gjatë tri javëve të këtij muaji në të gjitha

distriktet dhe nëndistriktet janë kryer 6 124 kontrole të konsumatorëve të energjisë elektrike për të cilët dyshohej se po keqpërdorin rrymën. Prej tyre mbi 500 u vërtetua se po e anashkalonin matjen e saktë të energjisë elektrike.

"Keqpërdorimi i energjisë elektrike është i papranueshëm dhe i dënueshëm. Rastet e tilla ekipet e KEDS-it do t'i parashtrajnë për procedura të metutjeshme gjyqësore", ka njoftuar KEDS-i.





AJAZ EMINI - Ditar (I)

# NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

## Jetëpërshkrim dhe ngjarje që nga lindja ime

Unë Ajaz Emini jam i lindur në fshatin Llojan të Kumanovës (Dardania e dikurshme), fshat që ndodhet në pjesën më veriore të Maqedonisë së Veriut.

Linda në një familje bujare nga nëna Sadia dhe babai Hamidi, të cilët njiheshin si njerëz të matur dhe të dashur ndaj të tjerëve. Linda në një familje që ndihmoi e ndau edhe kafshatën e bukës me ata që i kishte kapur skamja e madhe e kohës, e sidomos atyre që i kishin ikë terrorit dhe shtypjeve sllave nga ana e Karadakut të Preshevës dhe Gjilanit. Këta bashkë-kombas të cilët kishin lëshuar vatrat e tyre nga presioni i madh sllav, kishin ardhë dhe ishin vendosë në këtë fshat mikpritës dhe bujar.

Shumica e këtyre bashkëkombasve ishin në ikje

sëmundje e rëndë që e kishte marrë përderisa ishte në shërbimin e domosdoshëm të ushtrisë jugosllave, ku kishte qenë i angazhuar si ushtar i rregullt. E ku? Ku tjetër pos atje ku kanë dërguar shumicën shqiptare, në mbrojtje të kufinjve të Sllovenisë së Jugosllavisë së atëhershme.

Atje në ushtri gjatë asaj kohe ku nuk i kishin patur kushtet aspak të volitshme e në veçanti për shqiptarët. Pas ardhjes nga shërbimi ushtarak sëmunda ia vështrëson jetën edhe më tepër, ku në moshën 31-vjeçare vdiq në një moshë mjaft të re...

Pas vdekjes së babait, mbeta me nënën Sadien, motrën më të madhe Nergjizen dhe vëllain Murtezanin, nën kujdesin e axhës Emin i cili ishte më i riu ndër tre vëllezërit Demiri dhe Hamidi. Ai gjatë tërë jetës së tij nuk kurseu asgjë asnjëherë, vetëm e vetëm për t'i rritë fëmijët e vëllait të tij Hamidit dhe për t'i siguruar kushtet sa më të mira që



Babi Hamid Emini

Preshevës dhe pastaj u transferova në gjimnazin "Skenderbeu" të Kaçanikut legjendar. Po, aty ku trimi i Karadakut të Preshevës Idriz Seferi me luftëtarët e tij nga Presheva dhe Kumanova i kishin ardhë në ndihmë vëllezërve të tyre kosovar dhe kishin thyer ushtrinë Osmane më 1910 (në Grykën e Kaçanikut), kryengritje që njihet si një ndër më të përgjakshmet e asaj kohe.

Në gjimnazin "Skenderbeu" të Kaçanikut, unë me shumë shokë të tjerë të rrethit të Kumanovës u mirëpritëm nga drejtori i atëhershëm prof. Latif Nallbani me patriotët e mëdhenjë si: Dr. Fadil Raka edhe prof. Bedri Kyqyku. Në Kaçanik për mësimdhënës pata disa fytyra të ndritshme të çështjes kombëtare të asaj kohe siç ishin: prof. Bedri Kyqyku, Prof. Dr. Fadil Raka nga Kaçaniku, e më vonë edhe prof. Naim Ibrahimimi nga Kumanova, prej të cilëve mësova përveç lëndëve mësimore që kishim edhe atdhedashurinë. Aty u njoha me shumë shokë të rrethit të Kumanovës të cilët po përbënin një paralele në vete në këtë shkollë, bashkë me disa bashkëkombas të fshatrave të rrethit të Kaçanikut. Unë me shokët e rrethit të Kumanovës erdhëm në Kaçanik, pasi na ishte mohuar e drejta e shkollimit në gjuhën amtare shqipe nga pushteti sllavo-Maqedon në



Nëna Sadije Amid Emini

Jugosllavinë e atëhershme. Në Kaçanik u njoftova edhe me shokë, që më vonë do të njihen si patriotë të mëdhenjë të çështjes kombëtare si: vëllezërit e Komandant Ismet Jasharit: Xhemal dhe Murat Jasharin nga fshati Orizare e Kumanovës, Hysen Shurdhani, Xhemal Krivanjeva, Abdullah Çallakun, Ismajl Raka nga Kaçaniku, Nuri Rexhepin, Salim Zulfiu nga Likova e Kumanovës dhe shumë e shumë të tjerë. Në Kaçanik njoftova edhe shoqen e jetës, tani bashkëshorten Shahadije Hoxhën, të bijën e Kemal Hoxhës. Shaha-dija ishte mbesa e patriotit të mirënjohur Kaçanikas Ismail Hoxha, (i njohur, Mulla Ismaili) i cili më 8 Shtator 1944 kishte ngritë flamurin kombëtarë shqiptarë për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore në stacionin hekurudhor të Kaçanikut, i cili për këtë akt patriotik do të pësojë maltretime dhe tortura të pa para, për çka dhe detyrohet të shpërngulet në Turqi nga pushtuesi serb. Më vonë për shkak të vdekjes së birit të tij, ai kthehet që të kujdeset për fëmijët e të birit të tij, i cili në moshë të re kishte ndërruar jetë. Mulla Ismaili e kishte dashur pa masë shkollimin, ku pas kthimit në Kaçanik me mundin e tij ia arrinë të shkollojë nipin Maksutin dhe mbesat: Ajnishahen, Shahadijen edhe Naimen. Dy vitet e fundit të shkollës së

mesme me iniciativën e Dr. Prof. Ramiz Abdylit, Prof. Dr. Asllan Selmanit, Prof. Avni Deharit edhe Prof. Naim Ibrahimimit së bashku me të gjithë shokët e rrethit të Kumanovës, gati e gjithë paralela Kumanovare u transferuam që të vazhdojmë mësimin në gjimnazin "Goce Dellçev" të Kumanovës, me qëllimin kryesor të hapjes së paraleleve edhe në gjuhën shqipe në këtë shkollë, aty ku mohohej mësimi shqip për të gjithë neve shqiptarët e Maqedonisë! Mësimin në fillim e filluam jashtë objektit të gjimnazit për shkak të refuzimit maqedon, por ne filluam mësimin në objektin e shkollës fillore "Bajram Shabani" të Kumanovës. Ky objekt shkollor aspak nuk i përmbushte kushtet e shkollimit. Një vit më vonë me iniciativa të ndryshme na lejohet që të vazhdojmë mësimet në objektin e Gjimnazit "Goce Dellçev", ku përsëri shumica e lëndëve po zhvilloheshin në gjuhën maqedone edhe për shqiptarët, por me shpresë dhe qëllim që të hapnim paralelet e mësimi edhe në gjuhën amtare shqipe.

Në Kumanovë për kujdestar klase dhe mësimdhënës kishim bashkëvendasin, historianin e mirënjohur dhe patriotin e madh: Dr. Prof. Ramiz Abdylin, i cili ishte i vendosur që mësimi për nxënësit shqiptarë të zhvillohet vetëm se në gjuhën amtare shqipe edhe në këtë gjimnaz të Kumanovës për nxënësit shqiptarë të qytetit dhe rrethinës së Kumanovës. Pas të gjitha peripetive dhe pengesave që patën Prof. Ramizi me kolegët e tij nga pushteti sllavo-maqedon, ata ia arritën qëllimit që të realizojnë dëshirën e shumëpritur të gjithë popullit shqiptarë.

Më vonë me kalimin e kohës, shumica e këtyre profesorëve dhe nxënësve shqiptarë do të arrestohen dhe ndëshkohen me burgim dhe tortura më ç'njerëzore nga pushteti sllavo-maqedon, vetëm e vetëm pse kërkohet të drejtat elementare të njeriut që fëmijët e tyre të mësojnë në gjuhën e tyre amtare "SHQIP dhe vetëm SHQIP!"

Pas kryerjes së gjimnazit, unë përveç shkimeve pëlqëja pa masë edhe aktrimin. Meqenëse shkollë aktrimi shqip nuk kishte, konkurova në fakultetin e teatrit dhe filmit në Zagreb. Atje mbeta i dëshpëruar sepse nuk ia arrita qëllimit që të regjistrohem, ku shkaku ishte konkurenca jashtëzakonisht e madhe prej mëse 200 kandidatëve të paraqitur, ku u pranuan vetëmse 9 studentë! Pas monologut që kisha për provim pranues, komisioni më propozoi që të shkojë të regjistrohem në Shkollën e Lartë të Aktrimit në Prishtinë, duke më thënë se studentët shqiptarë që pranohen këtu zakonisht vijnë me propozim nga teatri apo Shkolla e



Xhaxhai Emin Emini

nga tokat e tyre stërgjyshore të Dardanisë që zgjatën gjatë tërë historisë së tyre, e sidomos në kohën e gjakpirësit serb Rankoviqit. Po, atëherë në atë kohë kur bëhej dëbimi i shqiptarëve për në Turqi me aksionin e mbledhjes së armëve nga shqiptarët autokton, e që i detyronin të lëshonin tokat e tyre dhe të iknin drejt shkretëtirave të Anadollisë së Turqisë.

Linda në pranverën e vitit 1954 në tokën e Dardanisë, atëherë kur ishte vala e dëbimit të popullatës shqiptare nga dora gjakatare sllave. Kështu siç më ka treguar nëna.

Gjyshi im, Bajram Dema ishte i mirënjohur në këto anë jo vetëm si një burrë punëtor, por edhe i zellshëm dhe bëmires i madh për të cilin asnjëherë nuk munguan fjalët e mira nga të tjerët që e njohën. Ai ishte atdhedashës i madh që disa herë klika pushtuese e kishin kërcënuar me jetë: si pueshtuesit bullgar, po edhe ato sllav.

Mua, qysh në moshën pesë vjeçare më vdiq babai nga një

ishte e mundur. Për këta gjëra i jam shumë mirënjohës.

## SHKOLLIMI IM DHE PRIRJET E MIA

Shkollimin fillor e kam kryer në vendlindje, në shkollën "Rilindja" - Llojan, aty ku isha nxënës shembullor, por që kisha për mësuës një plejadë të njohur të mësimdhënësve. Gjatë viteve të fundit në shkollën fillore inkuadrohem në grupin letrar të organizuar nga arsimtari i gjuhës dhe letërsisë shqipe Hysen Këqyku. Aty fillova me shkrimet e mia të para në prozë dhe poezi, ku me këto punime së bashku me grupin letrar shkuam dhe i lexuam para nxënësve në shkollën fillore të Miratocit dhe Sllupçanit. Më vonë gjatë shkollës së mesme disa prej punimeve të mia botohen edhe në gazetën e kohës "Rilindja" dhe revistat "Zëri i rinisë", "Shkëndija" që shtypeshin në Prishtinë.

Shkollën e mesme e fillova në gjimnazin "Skenderbeu" të



Vëllau Murtezan, nëna Sadija, motra Nergjizja dhe unë Ajazi



Lartë e Aktrimit në Prishtinë! Me vonesë për regjistrim në drejtime të tjera që i pëlqej, unë prej Zagrebit u ktheva në Universitetin e Prishtinës pas afatit të regjistrimeve. Në Universitetin e Prishtinës aty më ndihmojnë që të regjistrohem e dashura ime Shahadija, me të cilën njiheshim nga gjimnazi në Kaçanik, e cila kishte dajën e sajë Dekan të Fakultetit Juridik Prof. Hajredin Hoxhën, një patriot i madh i cili menjëherë intervenon edhe arrinë që të më regjistrojë në Fakultetin Juridik dega e Drejtësi-Gazetari. Në Fakultetin Juridik kisha edhe dajën Muharrem Shaljanin që studjonte drejtësinë, një aktivist poashtu i njohur i çështjes shqiptare, të cilin më vonë pas një kohe të shkurtër pas diplomimit dhe punësimit do ta arrestojnë, torturojnë dhe dënojnë me 5 vjet burg si armik i popullit dhe shtetit jugosllav!

Asnjëherë nuk më pëlqeu mua drejtimi i drejtësisë, por kisha synimin për të kaluar në drejtimin e gazetarisë që më vonë të merrem edhe me shkrime. Gjatë dy viteve të para të fakultetit juridik kisha shumë ndihmë edhe nga daja im Muharrem Shaljani, me të cilin jetonim së bashku në të njëjtën banesë. Gjatë vitit të parë të studimeve banonim në një banesë private, ku aty kushtet ishin minimale për jetesë! Gjatë vitit të dytë të studimeve dajës tim Muharremit si student i mirë, iu nda një vend në konviktin e studentëve pasi se Muharremi ishte absolvent në vitin e fundit të studimeve, si dhe për shkak të kushteve të vështira ekonomike që kishte. Qëndrimi im në konvikt ku po banoja ishte ilegal, edhe pse isha te daja im Muharremi. Ishte tepër vështirë të fitohet e drejta e banimit për një fillestar të studimeve, sepse numri i shtretërve në konviktin e studentëve ishte tepër i kufizuar! Gjatë kësaj kohe unë me



Në ditën e maturës në Gjimnazin "Goce Dellçev"- Kumanovë, 1974

Muharremin ishim në përcjellje edhe nga UDB'a jugosllave për aktivitetet dhe realitetin jetësor që po e bisedonim me të tjerët, e si duket bisedat e realitetit shqiptarë në jugosllavi dikujt nuk i kishte pëlqyer. Pas një kohe, pas një shpërndarje të afisheve edhe shkrimeve anti-jugosllave në muret e konvikteve të studentëve në Prishtinë, që të dy unë së bashku me Muharremin u arrestuam dhe na dërguan në stacionin policor të Prishtinës për hetime. Që të dy u arrestuam në një ditë herët të mëngjesit aty rreth orës pesë, derisa ishim në gjumë. Pas arrestimit dhoma jonë bastiset dhe që të dyve së bashku na dërguan në stacionin policor të burgut të Prishtinës. Atje u morëm në pyetje dhe na kërcënuan me tortura dhe burgosje në lidhje me shkrimet dhe afisheet që u gjendën në konviktin e studentëve. Dikur vonë në mbrëmjen e po të njëjtës ditë, që të dy u liruar. Gjatë

studimeve sigurimi i shtetit na kishte në sy dhe kishin angazhuar edhe bashkëpunëtorët e tyre të bëjnë përcjelljen në të gjitha tubimet dhe bisedat tona, si edhe kishin angazhuar edhe disa studentë që i kishin pasë shokë të mirë, e të cilët edhe në shumicën e rasteve i kishim ndihmuar atyre. Më vonë pas arrestimit dhe gjatë denimit të dajës Muharremit, kuptuam se ata që i kishim patur shokë, kishin qenë dëshmitarët dhe informatorët (kodoshët) kryesor në dënimin e tij!

\*\*\*

Muharremi pas diplomimit si jurist fillon punën në Kumanovë, ku dhe më 03 shkurt 1980 paraburgoset. Më 02 prill 1980 bastiset shtëpa ime dhe vëllait Murtezan Emini, Muharrem Shaljanit, Haxhi Maliqit dhe Ismet Memetit. Të gjithëve na zihet edhe mirret material propagandistik siç i thonin: libra që ishin botuar në ish Jugosllavi dhe Shqipëri, dhe tanimë ishin të ndaluara: revista "Shqipëria e Re" dhe disqe të ndryshme muzikore në shqip (disqe gramafoni, sipas raportit policor në dosjen e Muharrem Shaljanit) ku edhe arrestohen që të gjithë të lartë përmendurit. Më 02 Gusht 1980, Murtezan Emini vëllai im lirohet nga paraburgimi, kurse Muharrem Shaljani dënohet me 5 vjet burg, Haxhi Maliqi dënohet me 3 vjet burg dhe Gani Sylaj dënohet me 6 vjet burg për veprën penale si: "Armiq të popullit dhe shtetit jugosllav", sepse me veprimtarinë e tyre patriotike paskan pasë punuar për bashkimin kombëtarë. Shumë kohë para se të ndodhë arrestimi i Muharremit, unë veçse kisha lëshuar kufirin jugosllav. Së pari ika në Zvicër, ku pas disa javësh kalova në Austri. Në Austri në fillim u strehova te axha im Emini në qytetin e Vjenës të cilin e doja pa masë, sepse ai ishte edhe personi kryesor që në të gjitha mënyrat na kishte ndihmuar qyshë nga mosha e fëmijërisë sime 5 vjeçare, atëherë kur kishte vdekë babai im dhe kishim mbetë jetim me vëllain Murtezanin dhe motrën Nergjizen.

Nga Austria përsëri u ktheva edhe një herë vetëm për disa ditë në vendlindje, edhe atë më tepër që ta njoftoja dhe të mirresha vesh me të dashurën time Shahadijen për planet e largimit. Shahadija nuk e mirëpriti këtë lajm në lidhje me planet për të ikur në Amerikë. Kështu që me zemër të thyer u ktheva prej nga kisha ardhur, pra për në Vienë të Austrisë. Gjatë kësaj kohe, pas tre ditë bredhesh Maqedoni-Kosovë, duke e ditur problemin me pushtetin e atëhershëm jugosllav, i ika edhe njëherë kurthës policore të cilët tani ishin në kërkimin tim. Të nesërmen menjëherë pas largimit tim për në Austri, policia maqedone shkojnë për të më arrestuar në shtëpinë time në Llojan, ku edhe kryejnë bastisjen e shtëpisë time. Kësaj here ishin me vonesë, pasi unë vetëm isha larguar dhe isha jashtë kufirit jugosllav.

\*\*\*

Tani po iu paraqes disa dëshmi

nga libri "Dosja" e Muharrem Shaljanit, e cila është e tërë dosja policore (UDB-së) e Muharrem Shaljanit e botuar nga vetë Muharremi, aty ku shihen shumë qartë shkrimet nga dosja për përndjekjen tonë të përbashkët. Në dosjen e tij bëhet fjalë për arrestimin dhe burgimin, si dhe për aktivitetet e Muharremit të botuar më 2016. Aty kuptojmë se me Muharremin në ndjekje isha edhe unë me vëllain Murtezanin, prej ku tani po shkëpus disa pjesë nga ky libër. Në faqen 11, në raportin e përpiluar të datës 19 Prill 1976; marrë nga origjinali.

-Vlerësimin e Punëtorit Operativ nga Inspektor Haki Bediu - "Bashkëpunëtori (kodoshi me nofken BIMI- Milazim Bislimeshok, student nga fshati Llojan) është aktivizuar tash, të cilit iu dhanë përveç detyrave të përgjithshme edhe disa detyra konkrete, gjegjësisht të takohet me Ajaz Eminin dhe Muharremin, që të dy studentë në Prishtinë, për të cilët kemi të dhëna se vepron në baza nacionaliste.

Nga kjo çka na solli bashkëpunëtori mundë të konstatohet se Muharremi paraqet interes te ne, në shërbimin e sigurimit shtetëror. Biseda u krye vetëm në mes atyre të dyve, për atë edhe nuk mundë të vërtetohet, por prap e marrim si të saktë, sepse kodoshi nuk e ka vetinë që të gënjejë ose që t'i zmadhojë gjërat. Për Muharremin edhe nga e kaluara kemi njohuri për disa veprime të ngjajshme: flamuri kombëtarë, harta e Shqipërisë së Madhe, fotografitë e Enver Hoxhës etj. Por, deri tani nuk është marrë në bisedë informative.

Në bazë të asaj që u tha dhe asaj se për Kumanovën Muharremi ka pasqyrë totalisht të gabuar për barazinë e shqiptarëve.



Me të dashurën Shahadijen



Me djalin e dajës Muharrem Shaljanin





1 Korrik 1990 Gjirokastrë, nga vizita e parë në Shqipëri (grupe prej 12 vetash)

\*\*\*

-Në faqen 22 të Dosjes shkruan; "Vura re nën dritare, në murishte parulla "VDEKJE OSE LIRI" me laps kimik dhe shkrimi ishte i Ajazit". E datës 26 Qershor 1976.

\*\*\*

Pas dy muajsh qëndrimi me axhën Eminin, i cili ishte me punë të përkohëshme në Vjenë të Austrisë, një ditë vendosa që t'i tregoja qëllimin atij se pse kisha shkuar aty! I tregova axhës tim se po planifikoja për ikje në SHBA, atje ku kisha edhe familjen e dajës tjetër Shaip Amidit me djemtë e tij Feratin dhe Sedushin të cilët ishin moshatar të mi! Në fillim axha im u mërzi shumë nga ky lajm, ishte prekur shumë duke menduar se nuk ia kishte arritë qëllimit që të m'i plotë-sonte të gjitha kushtet, ndaj më lutej dhe insistonte që unë asesi mos të largohem, por të kthehem të kryejë studimet në Prishtinë. Ai më premtoi se do të më plotësojë çdo dëshirë që do të shprehja, duke më premtuar se do të më blejë edhe veturë, ku për jetën studentore në atë kohë ishte diçka thuajse e pa imagjinueshme, vetëm e vetëm që të qëndroja afër tij...Gjatë kohës sa isha në Vienë të Austrisë, në fillim fillova të punoja në një kopshtari me një të afërm timin që po punonte atje. Vjena njihet si metropol botërorë me shumë monumente historike. Pos punës që bëja aty vizitova shumicën e pallateve të bukura mbretërore që datonin qysh nga mbretëria Austro-Hungareze, si dhe Muzeun Historik (Kunsthistorisches Museum) në qendër të qytetit, aty ku gjendej origjinali i përkrenares dhe shpatat e kryetrimt legjendar Gjergj Kastriotit-Skenderbeut. Në Vjenë vizitova edhe Ambasadën e Republikës së Shqipërisë, atje ku u pritja shumë mire në mënyrë vëllazërore nga stafi i ambasadës

me të cilët edhe bëra një marrëveshje për shfaqjen e filmave shqiptarë për punëtorët e komunitetit shqiptarë nga Jugosllavia, që ishin me punë të përkohëshme në Austri. Gjithashtu bëmë marrëveshje edhe për furnizimin e tyre me libra dhe revista nga Shqipëria! Mirëpor, pasi u takova me punëtorët shqiptarë në klubet jugosllave që ishin atje, gjatë bisedës me to, ata më këshilluan që mos ta zhvilloja këtë aktivitet sepse do t'i bëja shumë telashe vetes dhe punëtorëve shqiptarë me regjimin jugosllav i cili me degët e tyre të UDB's shumë gjëra po përcilleshin në lidhje me të gjitha lëvizjet shqiptare në vendet perendimore! Shumica e këtyre klubeve të punëtorëve ishin më tepër edhe si klube përgjimesh për punëtorët shqiptarë nga Jugosllavia. Pas një kohe në Vjenë të Austrisë, iu bashkova shokut tim Kumanovarë nga studimet Hamzi Veseli, me të cilin herët kishim planifikuar arratisjen nga Jugosllavia. Pas ardhjes Hamziut, disa ditë më vonë që të dy së bashku shkuam dhe u paraqitëm për statusin e refugjatëve në Kampin e Traiskirchen'it, i cili ndodhet rreth 20 km. në jug të qytetit të Vjenës, qytetit të kulturës dhe historisë Europjane. Në pamjen e parë kampi ishte me të gjitha rrethojat dhe rojen, që më tepër i përngjante një burgu i cili ishte në një fushë të gjërë dhe i rrethuar me shumë vreshta. Ky kamp u kishte shërbyer shumicës së të ikurve politik nga vendet e ndryshme të lindjes, të sistemit komunist. Sipas informacioneve ky kamp ishte themeluar që nga kriza Hungareze e vitit 1956. Në Kampin e Traiskirchen'it ishin vendosur të ikurit nga mëse 30 shteteve komuniste si: Shqipëria, Jugosllavia, Polonia dhe e gjithë Evropa Lindore. Aty ishin të vendosur njerëzit me bindjet

politike, po edhe fetare që nuk pajtoheshin me sistemet në vendet e tyre. Kishte edhe të atillë që kishin ikur për shkaqe ekonomike dhe në kërkimin e punës jashtë atëdheut. Kishte nga ato që kishin arsyen e shkollimit, mirëpor këtu paraqiteshin si të përndjekur politik, për çka edhe kërkonin azil për të drejtë jetese diku në vendet perendimore. Që të gjithë që ishin aty, kishin një qëllim. Ata donin një jetë të re jo vetëm për ato, por edhe për të ardhmen e fëmijëve dhe familjeve të tyre. Jeta në kamp nuk ishte e lumtur, ku më tepër i përngjante një burgu demokrat që nuk ushtrohej dhunë. Kushtet në kamp nuk ishin aq të mira, për të cilën edhe ishin kritikuar nga Amnesty International për kushte jo të volitëshme për refugjatët. Unë me grupin e shqiptarëve që takova atje, ishim të mbyllur në katin e dytë, në një dhomë sikur në kazeremat ushtarake. Aty ishim vendosur 12 shqiptarë. Të gjithë ishim nga Jugosllavia, mirëpor të paraqitur si të ikur nga Shqipëria për shkak se më lehtë përfitohej leja e vendqëndrimeve nëpër shtetet perendimore. Për t'u ushqyer duhej shkuar në katin e parë, por gjithmonë të shoqëruar nga garda policore e kampit. Pas dy muajsh qëndrimi në Kampin e Traiskirchen'it, ne u dërguam në Kampin e Badkreuzen'it në një fshat malor afër Lincit. Kushtet në këtë kamp ishin shumë më të volitshme dhe më të mira. Në kamp kishim një dhomë për vetëm dy veta, me pastërti në nivel të mirë, por edhe ushqimin shumë më të mirë dhe më cilësorë. Në Kampin e Badkreuzenit kalova edhe gjashtë muaj të tjerë, në ndërkohë mora ftesat për interesim nga aplikimet e bëra më herët për vendet e dëshiruara për emigrim. Ato ftesa i kishim bërë më herët për në disa shtete të ndryshme. Kërkesa e parë e imja ishte Amerika, e pastaj për Australi dhe Kanadë. Ftesa e parë që na u bë ishte ajo nga Ambasada e Australisë, që na aprovoi vizat që të dyve, mua Ajazit dhe Hamziut për të

emigruar në Australi! Pas një jave na erdhi edhe ftesa e dytë për intervistim në Ambasadën Amerikane, të cilën po e prisnim me padurim, për të cilën donim të aprovohet më së tepërmi. Intervista shkoi në rregull për mua, aty mu dha leja për emigrim në SHBA, kurse shokut tim Hamziut iu refuzua lutja! Pas intervistës unë me Hamziun u morëm vesh: unë të shkoj në Amerikë, kurse Hamziu për Australi, me shpresë që ku të jetë më mirë atje të bashkohemi përsëri. Kjo nuk u realizua asnjëherë...

## ARDHJA IME NË AMERIKË

Më 21 qershor 1979, unë u nisa rrugës për në tokën e premtuar, tokën e shpresës dhe lirisë në Amerikën e largët atje përtej Atlantikut. Në aeroportin e Vjenës të Austrisë, më përcollën axha Emini me një shok, bashkëvendas i yni. Ata u mërzi të pa masë edhe pse iu premtuam se me çdo kusht do të kthehem pas 3-4 vjetësh, e që edhe sotë pas 40 vjetësh mbeta këtu në SHBA. Nga aeroporti i Vjenës, destinacioni ynë ishte për në metropolin botërorë, pra në Nju Jork, atje ku po më priste një përfaqësues i organizatës CARITAS. (CARITAS, nga latinishtja don të thotë "Dashuri në mes të Kombeve")- e që është organizatë katolike që ndihmon refugjatët dhe ata që kanë nevojë. Personi apo përfaqësuesi që takova më dha \$100 kesh dhe më udhëzoi për në fluturimin tjetër vijues nga Nju Jorku (New York) për në Klivlend të Ohajos (Cleveland, Ohio) ku po më prisnin familja e dajës Shaip Amidit të ardhur nga fshati Likovë të Kumanovës. Pas arritjes në Cleveland, në fillim u vendosa te familja e dajës Shaip të cilët më mbajtën dhe më ndihmuan derisa fillova punën dhe jetën time në Amerikë. Fillimisht u punësova në një fabrikë për përpunimin e metaleve te djemtë e dajës Farati edhe Sedushi. Pas dy

muajsh me ndihmën e një shoku që kishte ardhë shumë vite më herët nga Shkupi, e që quhej Agim Bajra, kalova në një fabrikë tjetër ku po punonte ai, e që kishte pagesën dhe me kushte më të mira. Mirëpor pas dy vjetësh pune filloi kriza Amerikane pas problemeve në Lindjen e Mesme në mes të SHBA'së dhe Iranit. Pas kidnapimit të stafit të Ambasadës Amerikane në Teheran gjithëçka po vështirësohej. Me të shpejtë kishim ramjen drastike të industrisë, fabrika ku po punonim shkante drejt mbylljes dhe na liruan shumicën e punëtorëve. Nga fabrika u detyrova të kaloja në një profesion krejtësisht tjetër, në atë të gastronomisë. Si shumica e posa të ardhurve në Amerikë, ashtu edhe unë fillova punën në restorant. Punën e parë që fillova aty isha enëlarës në lokal in e një shqiptari. Pas një kohe të shkurtër me aftësitë që tregova, më ngritën pozitën dhe më dhanë punën e ndihmës kamarierit. Pas disa muajve edhe pse ende nuk e përvehtësoja gjuhën angleze sa duhet, mirëpor ishte theksi im që po e pëlqenin myshterijet që iu shërbeja, ku me të cilët më vonë u bëmë edhe shokë e miq. Ata gjithënjë rezervonin vendet në restorant ku po punoja unë, me qëllim që t'u shërbeja unë! Me punën time të palodhëshme, pas një kohe më emëruan menaxher të restorantit aty ku po punoja. Restoranti quhej "The Glass Garden Restaurant" i cili ishte i veçantë dhe në periferi të qytetit. Restoranti ishte me renome në këtë rajon, ishte shumë i njohur me specialitetet e ushqimeve franceze dhe italiane. Kishte një dekor të natyrës së gjallë me lisa dhe lulet e ndryshme në brendësi. Përrocka uji dhe ujvarat e vogla me lloje të ndryshme të peshqve që notonin si dhe akuariumet e ndryshme të peshqve ia jepnin bukurinë dhe veçantinë. Gjithashtu kishte edhe shumë kafaze me lloje të ndryshme të bilbilave dhe papagajve. Me kalimin e kohës dhe eksperiencën që përfitova aty, vendosa më vonë që të blejë biznesin e restorantit



13 Shkurt 2008 Lakewood /SHBA, me mikun e madhë të shqiptarëve, Kongresmenin Amerikan Eliot Engel.



dhe për çka mora të drejtën që të bëhem edhe pronar restoranti.

Derisa isha i punësuar nëpër restorantet e ndryshme, pata rastin të takohem, të njihem dhe shoqërohem me personalitete dhe njerëz të ndryshëm me profesione të ndryshme dhe me famë. Gjatë kësaj kariere pata rastin që të shoqërohem dhe punojmë së bashku edhe me aktorin tani me famë botërore Robert Patrick. Me Robert Patrickun përpos punës së kamarierit, kur kishim kohë të lirë ushtronim edhe profesionin e modelit të sfilatave dhe veshëmbathjeve të ndryshme! Si model u angazhova në shumë sfilata mode për shtëpitë më të mëdha tregtare të qytetit të Klivlendit, si: "May Co.", "Higbees" e shumë të tjerave. Gjatë kësaj kohe pata fatin të reklamoja e të bëja edhe shumë fotografi për katalogje dhe albumet e fotografistëve më të njohur që vepronin në qytetin dhe rrethinën e Klivlandit. Gjithashtu bëra një mori fotografishë edhe për shtëpinë më të madhe botërore të kartave të ndryshme festive për "American Greetings", si kartat festive të Këshëndjellave, Ditën e Shën Valentinit e tjera. Gjithashtu bëra disa reklama të ndryshme televizive për restorante, për shtëpinë më të njohur të mobiljeve "Thomasville", si dhe u zgjodha të përfaqësoja veshëmbathjet e "Ralph Lauren" në reklamata lokale si dhe shumë promovime të ndryshme filmash dhe kozmetikë. Derisa ushtrova profesionin e kamarierit, pata rastin të takohem edhe me: bokserin e njohur Muhamed Ali, promotorin e boksit Donald King, aktorët Antony Quinn, Richard Dreffus, Alec Baldwin, pjesëtarët e grupit Rolling Stones, Police etj. Gjatë viteve derisa po punoja nëpër restorante, pata fatin që t'u vijë në ndihmë dhe të punësojë shumicën e shqiptarëve të ardhur në këtë qytet të Amerikës. Ndihamen time fillimisht e drejtova drejtë bashkëkombasve tanë këtu në rrethin ku veproj. Shumica e posa të ardhurve shqiptarë që po vinin në qytetin dhe rrethin e Klivlendit nga tokat shqiptare, si pikë fillimi e kishin restorantin ku po punoja unë, e pastaj me eksperiencën dhe mësimin e gjuhës secili e gjente veten aty ku e pëlqenin. Në Klivlend gjatë asaj kohe numri i shqiptarëve ishte shumë i vogël. Edhe ata që ishin në këtë qytet, ishin prej emigracionit shumë të hershëm. Në përgjithësi edhe këta të rinjë që kishin ardhur më vonë, shumica prej tyre ishin shumë pro-jugosllav apo pro-grek me të cilët edhe nuk shoqëroheshin aq shumë.

Veprimtarinë time patriotike e vazhdova më tepër në mënyrë vetiaku pasi e përvetësova deri diku gjuhën angleze. Me kalimin e kohës fillova të bëjë edhe lidhjet sado të pakta edhe me shqiptarët e Detroitit dhe të Nju Jorkut. Në fillim aktivitetet patriotike i fillova pasi u anëtarësova në grupin "Amnesty International" të Klivlandit (Cleveland, Ohio), këtu në SHBA. Ky grup kishte për qëllim që t'u dalë në ndihmë të

përndjekurve politik nga e tërë bota, e në veçanti të sistemit komunist. Ky grup i Amnestisë në Klivlend kishte rreth 10-12 anëtarët e rregullt, ku të gjithë ishin në moshë të shtyer. Shumë prej tyre ishin edhe të pensionuar, si dhe ishin me profesione të shkollimeve të larta. Nga ky grup unë isha më i riu vetëmse 25 vjeç, dhe i vetmi unë isha emigrant i posaardhur në SHBA në këtë grup. Ky grup i Amnestisë kishte marrë përsipër të ndihmojë disa emra të njohur të burgosurve politik siç ishin: disidenti i apartajdit në Afrikën e Jugut Nelson Mandela i cili kishte mbajtur 28 vjet burg, disidenti i Çekoslovakisë Vaclav Havel, disidenti shqiptar që po dirgjej burgjeve të Jugosllavisë Adem Demaçi i cili kishte mbajtur mbi 28 vjet burg, dhe më shumë se 100 shqiptarëve të tjerë si Robert Rasaj, Hava Shala, Muharrem Shalajani, Axhi Maliqi, Gani Sylaj edhe shumë e shumë të tjerë, kryesisht në Jugosllavi. Puna më kryesore e grupit tonë të Amnestisë ishte që secili prej nesh të merr përsipër disa persona, dhe në emër të Amnestisë nëpërmjet letrave të shkruara të njoftojmë për të burgosurit politik kryesinë e shteteve përkatëse ku mbaheshin të burgosur. Duhet të njoftojmë me letra të shkruara anëtarët e Kongresit dhe Senatit Amerikan, gjithashtu edhe liderët tjerë eminent e shtetërorë dhe botërorë. Që nga viti 1980 kur isha anëtarësuar në Amnestinë Internacionale të grupit të Klivlendit, kryesisht punova në zbardhjen e fatit të burgosurve politik shqiptarë, dhe çështjen e rëndë të shqiptarëve në Jugosllavi. Letrat tona patën shumë efekt, ku për shkak të tyre çështjet e shqiptarëve shumë herë u diskutuan edhe para Kongresit dhe Senatit Amerikan, nga të cilat më vonë rezultojnë në një numër rezolutash që u kaluan në këto instucione për shkeljet brutale kundër të drejtave shqiptare në Jugosllavi. Ndër temat më të njohura të cilat ishin të dokumentuara nga unë ishin: keqtrajtimet dhe torturat ndaj të burgosurve politik shqiptar, vrasjet e të rinjëve shqiptarë në kazermat e ushtrisë jugosllave, shuarja e demonstratave paqësore në mënyrat më brutale, helmimet masive të nxënësve shqiptarë në shkollat e ndryshme të Kosovës, rrënimi i rrethojave (mureve) të shtëpive shqiptare në Maqedoni nga pushteti jugosllav, si dhe montimet e ndryshme gjyqësore ndaj shqiptarëve të pafajshëm. Për këtë akcion të suksesshëm flasin edhe një seri letrash të ardhura në emrin tim nga shumë kongresmen dhe senator amerikan siç ishin nga senatorët: Robert Dol, Alfonso D'Amato, John Glen, Howard Mezzabaum, Richard Blumenthal, si dhe nga kongresmenët: Tom Lantos, Eliot Engel, Susan Molinari dhe shumë e shumë të tjerë.

Gjatë kësaj kohe isha edhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në demonstratat e shumta në Nju Jork, Detroit dhe disa qytete tjera të SHBA'së.

Të drejtat e shqiptarëve në



2005 Cleveland /SHBA, së bashku me themeluesen e shoqatës shqiptare, Këshilltaren e qytetit, arbëresho-amerikanen Dona Brady dhe Don Brady.

Jugosllavi ishin tepër të zymta, ato shkileshin në të gjitha sferat e jetës. Sipas statistikave për të drejtat e njeriut në Kosovë, prej vitit 1989 ishin vrarë mëse 150 të rinj shqiptarë nga forcat policore serbe (jugosllave).

Vetëmse në vitin 1996 ishin vrarë 14 të rinjë për shkak se po demonstironin në mënyrë paqësore apartajdin e regjimit jugosllav. Që nga pranvera e vitit 1981, pas demonstratave të famshme studentore kishte mbi 66 të rinjë shqiptarë që ishin vrarë në rrethana shumë të dyshimta derisa po shërbenin në ushtrinë jugosllave.

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 1996, më shumë se 3,657 shqiptarë etnik u maltretuan, u rrahën dhe u torturuan në mënyrat më brutale. Deri në fund të po atij viti ky numër u rrit në mbi 5000 shqiptarë të ndëshkuar! Në fillim të vitit 1997 u vranë 5 shqiptarë nga policia serbe (e Millosheviqit), dhe mbrenda një jave u arrestuan mbi 100 shqiptarë të tjerë të cilët u ndëshkuan dhe u dënuan pa kurrëfarë faji, vetëmse ishin shqiptarë.

Mes viteve 1981 deri në vitin 1993 mbi 3,200 shqiptarë u dënuan prej një viti deri në 20 vjet burg për shkaqe politike, dhe mëse 30,000 të tjerë të burgosur shqiptarë u dënuan me nga 60 ditë burg, dhe mbi 80,000 shqiptarë të tjerë ishin marrë në hetime nga policia serbe pa kurrëfarë arsye, vetëmse që ishin shqiptarë!

Gjatë kësaj kohe nga pushteti serb u përjashtuan prej pune më shumë se 147,300 punëtorë shqiptarë, që donë të thotë se mbi 80% të punësuarve shqiptarë u larguan dhunshëm nga puna. Gjatë kësaj kohe mbi 450 kompani shoqërore u vunë nën administrimin emergjent serb, mbi 4,000 biznese të vogla u mbyllën prej 6 muajsh deri në 1 vit. Mbi një milion shqiptarë mbetën pa kurrëfarë të ardhurash, ku nuk kishin as kushtet elementare për ekzistencë, mbi 80% të shërbimeve shëndetësore ishin nën masa të veçanta, dhe dhjetëra ambulanta nëpër fshatra

i kishin mbyllur krejtësisht. Më tepër se 2,400 punëtorë shëndetësorë (mjek, motra medicinale dhe stafi i tyre) i kishin larguar nga puna që po punonin, 157 prej tyre ishin prej stafit të mësimdhënësve në Fakultetin e Mjeksisë, mbi 70,000 nxënësve shqiptarë iu ndalohet hyrja në ndërtesat e shkollave të tyre, ndërsa mëse 22,000 mësuesve të tyre nuk iu ishte bërë pagesa e punës për më tepër se 7 vite. Gjithashtu 837 profesorë me asistentët e tyre ishin pushuar nga puna e tyre në universitete, e që don të thotë se 95% e stafit mësimorë dhe administrativ që përfaqësojnë pra ishin të pushuar nga puna. Jeta e shqiptarit në Jugosllavi ishte bërë e pa durueshme, ajo ishte që na shtyri neve dhe shumicës që e ndienim veten shqiptarë të bëjmë gjithëçka që është e mundur për njerëzit tanë dhe vendlindjen tonë, edhe largë prej këtej Atlantikut! Dhimbja për njerëzit tanë dhe atdheun, ishte ajo që na shtyri të llobojmë dhe bëjmë protestat gjithëkund ku ishte nevoja, e që për fat të mirë ia arritëm qëllimit, që të bëjmë shumicën e udhëheqësish Amerikanë që të dëgjojnë zërin dhe dhimbjet tona!

\*\*\*

Gjatë qëndrimit tim në Klivlend të Ohajos, isha vazhdimisht i përndjekur edhe këtu nga qarqet jugosllave, ku me ndihmën e një punëtorit të tyre shqiptar që kishin në Kosullin jugosllav në Klivlend, i cili më vonë më dorëzon edhe ftesën për paraqitje të Shërbimit Ushtarak në Armatën e Jugosllavisë, të cilës ftesë asnjëherë nuk iu përgjigja, edhe pse sipas ligjit jugosllav secili qytetar i lindur në Jugosllavi ishte i obliguar që të kryente edhe këtë shërbim të mallkuar ushtarak jugosllav, për të cilin gjithmonë e kisha urrejtje të madhe.

Shërbimit ushtarak i kisha ikë derisa isha në Jugosllavi, për shkak të shkollimit tim universitar që na pritinin që pas mbarimit të studimeve të kyçemi edhe në obligimin e kryerjes së shërbimit ushtarak. Gjatë kohës

derisa unë isha në studime, vendosa dhe ika jashtë shtetit jugosllav, në fillim shkova në Zvicër, dhe pastaj në Austri, e më vonë erdha këtu në Amerikë. Pas ardhjes në Amerikë, në fillim u regjistrova në kursin e emigrantëve të posa ardhur në Amerikë për gjuhën angleze, pasi se nuk e njihja aspak këtë gjuhë. Gjatë këtij kursi mësova gramatikën dhe vetëmse gjërat më elementare të gjuhës angleze. Mirëpo më vonë me ndihmën e shoqërisë, por edhe nga interesimi im personal për të mësuar gjuhën arrita që ta e përvetësojë gjuhën angleze deri diku, e cila më lehtësoi edhe shumë më tepër jetën time këtu në Amerikë. Pas përvetësimit të gjuhës angleze, në fillim tentova që të regjistrohesh në Fakultetin e Drejtësisë në "Cleveland State University" me qëllim që t'i transferojë disa nga provimet e kaluara nga Universiteti i Prishtinës. Mirëpo që në fillim mbeta shumë i zhgënjyer sepse prej të gjitha provimeve që kisha dhënë më pranohej vetëmse një provim, edhe atë ai Statistikës, po edhe ai ishte në pikëpyetje! Arsyja e mospranimit të provimeve nga Universiteti i Prishtinës ishte se në Jugosllavi ishte sistemi i drejtësisë komuniste, për çka më vonë e ndërrova drejtimin dhe u regjistrova në kolegjin e Lakeland'it aty ku vazhdova studimet e inxhinjerisë. Edhe këtë kolegji u desht që ta ndërpreja pas disa semestrave për shkak të orarit të punës në departamentin që më bënë. Isha i obliguar që të punoja në tre ndërrime (ç'do dy javë ndërronim nga një ndërrim në tjetrin ndërrim të punës, nga i pari në të dytin dhe pas dy javësh në të tretin e kështu me radhë. U detyrova të ndërpres studimet për një kohë, sepse puna që po bëja ishte e vetmja që më mbulonte shpenzimet e jetesës, por edhe për ndihmën sado modeste që i bënim familjes. Më vonë, pas disa vitesh përsëri vazhdova studimet në mënyrë të çrregullt dhe arrita të diplomohem me sukses në Administratën e Biznesit. **Vijon**



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



Veton Zymberi, redaktor i sportit

## Ademit i caktohet masa e arrestit shtëpiak prej 30 ditësh



**PRISHTINË, 23 MARS** - Gjykata Themelore në Prishtinë ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke i caktuar masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 30-ditësh Agim Ademit, kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), i dyshuar për "Keqpërdorim të besimit" dhe "Shmangie nga tatimi". Lajmin e ka konfirmuar për "Betimi për Drejtësi", Mirlinda Gashi, zëdhënëse e kësaj gjykate. Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte paraqitur kërkesë për caktimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj kreut të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, nën dyshimin se ka keqpërdorur buxhetin e FFK-së. Lajmin për "Betimi për Drejtësi" e kishte konfirmuar zëdhënësjja e kësaj Prokurorie, Laureta Ulaj. "Ju njoftojmë se Prokurori i Shtetit ka

paraqitur kërkesë për caktimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj A. A. në Gjykatën kompetente", thuhet në njoftimin e Ulajt. Në raportin 24-orësh të policisë të publikuar të enjten thuhet se Ademi dyshohet se ka kryer veprat penale "Keqpërdorim i besimit" dhe "Shmangie nga tatimi", duke keqpërdorur buxhetin e FFK-së. Prokuroria Themelore në Prishtinë të mërkurën ka njoftuar se Ademi është ndaluar për 48 orë nën dyshimin për kryerjen e veprave penale "Keqpërdorim i besimit" dhe "Shmangie nga tatimi". "Prokuroria Themelore në Prishtinë njofton opinionin publik se pas ndërmarrjes së veprimeve paraprake hetimore, Prokurori i Shtetit ka lëshuar aktvendim mbi ndalimin e kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës për shkak të

dyshimit të kryerjes së veprave penale 'Keqpërdorimi i besimit', nga neni 330 dhe 'Shmangie nga tatimi', nga neni 307 i KPRK-së. I njëjti me urdhër të Prokurorit të Shtetit është dërguar në mbajtje në kohëzgjatje prej 48-orësh, derisa në koordinim me policinë janë duke u ndërmarrë veprime hetimore lidhur me këtë çështje penale", thuhet në njoftim. Një ditë më parë Policia e Kosovës ka njoftuar se është intervistuar në stacion policor një zyrtar i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), ndërsa kreut të kësaj të fundit, Agim Ademi, i ishte lënë ftesë për t'u intervistuar të mërkurën. Më 15 mars 2023 Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim lirues ndaj Agim Ademit dhe Muharrem Ramës lidhur me akuzën për "detyrim në bashkëkryerje".

### SHKURT

#### Kosova U16 pëson humbje edhe nga Gjibraltari

Përfaqësuesja e Kosovës U16, e cila po udhëhiqet nga trajneri Arbnor Morina, ka pësuar humbjen e dytë në turneun që po e zhvillon në Bullgari. "Dardanët" e rinj kanë pësuar humbje nga Gjibraltari me rezultat 2:1. Kjo është humbja e dytë radhazi, derisa të parën e ka humbur nga Bullgaria 2:0. Ndeshjen e fundit Kosova e zhvillon me Maqedoninë e Veriut.

#### Shqipëria U19 triumfon ndaj Maltës

Kombëtarja e Shqipërisë U19 korri fitore me rezultatin 2-0 përballë Maltës në sfidën e parë miqësore të planifikuar për këtë muaj. Në ndeshjen e zhvilluar në Maltë, kombëtarja kuq e zi e drejtuar nga trajneri Armando Cungu bëri paraqitje fantastike. Këtë e vërteton edhe rezultati final i këtij takimi të parë miqësor. Autorë të golave ishin Gent Elezaj dhe Ardit Nuredini. Ndeshja e dytë miqësore ndaj Maltës është planifikuar të luhet tri ditë më pas, më 26 mars, me fillim nga ora 11:00. Bile në këtë ballafaqim minuta pati për të gjithë lojtarët e grumbulluar për këto dy ndeshje.

#### Mbahet Kuvendi i Punës i FBK-së

Është mbajtur Kuvendi i Punës i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Në këtë Kuvend kanë marrë pjesë 31 delegatë nga 40 gjithsej sa numëron Kuvendi. Më pas është miratuar Rendi i Ditës, ku nuk kishte kundërshtime. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, ka folur për të gjitha pikat e rendit të ditës e që ishin: Raporti i Aktiviteteve të FBK-së për vitin 2022, Raporti i Auditimit për vitin 2022, Draft Plani i Veprimit 2023, Draft Plani Financiar 2023, Draft Plani i Marketingut 2023 dhe të ndryshme. Fetahu ka folur për punën që është bërë gjatë vitit që lamë pas, si dhe sfidat që na presin gjatë vitit 2023. I pari i basketbollit të Kosovës ka kërkuar përkrahjen e të gjithëve për projektet për zhvillimin e basketbollit të Kosovës. Kuvendi ka zgatur rreth një orë, ndërsa në fund si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës është emëruar Dren Zatriqi, duke zëvendësuar Artan Spahijën, me kërkesën e këtij të fundit.

### Vazhdon shitja online e biletave për ndeshjen Kosova - Andorra

**PRISHTINË, 23 MARS** - Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se biletat për ndeshjen Kosova - Andorra, në kuadër të

kualifikimeve për "Euro 2024", e cila zhvillohet më 28 mars, në orën 20:45, në stadiumin "Fadil Vokrri", vazhdojnë të shiten përmes

platformës online: <https://eu.ebileta.al/biglietteria/li-staEventiPub.do>. Çmimet e biletave janë: Veri dhe

Jug 5 euro, Lindje 10 euro, Perëndim 20 euro dhe VIP 80 euro. FFK-ja ka njoftuar se një person mund të blejë deri në katër bileta.





## Bagnaia: Kujdes nga garat sprint, ky është çelësi i suksesit

Romë, 23 mars - Këtë fundjavë nis sezoni i ri në MotoGP dhe të gjithë presin ta shohin reagimin e kampionit të botës, italianit të Ducati, Francesco Bagnaia. Pasi korri vjet titullin e parë në karrierë, ai ka misionin e vështirë ta mbrojë atë, në një sezon me shumë risi. Gara

sprint që do të zhvillohet çdo të shtunë mbetet një enigmë për të gjithë. "Më në fund do të nisë sezoni i ri dhe jam entuziast. Testet dimërore shkuan mirë dhe në disa aspekte ky motor në pëlqen më shumë se ai i vitit të kaluar. Janë të gjitha mundësitë që

këtë sezon ta nisim më mirë se vjet. Garojmë në Portimao, një pistë që më pëlqen dhe ku në përgjithësi kemi shkuar mirë", ka thënë Bagnaia. "Gjithsesi, duhet të jemi të përqendruar, pasi rivaliteti është shumë i fortë dhe i madh këtë vit. Duhet të punojmë e

paraqitemi mirë, pasi çdo fundjavë ka shumë në lojë. Këtë sezon do të kemi garën sprint çdo të shtunë, ndaj duhet një përgatitje optimale. Çdo pikë është e rëndësishme, këtë gjë e kuptova vjet, ndaj sa më pak gabime. Ky është sekretin për të fituar", ka shtuar Bagnaia.



## FFK-ja paraqet fanellat e reja të Përfaqësueses

PRISHTINË, 23 MARS - Rrugëtimin drejt Kampionatit Evropian Kosova e fillon me uniformë të re. Federata e Futbollit e Kosovës ka lansuar sot linjën e re të veshjeve dhe pajisjeve sportive të brendit të njohur italian "Errea". Me fanellat e reja, të cilat përfshijnë ngjyrat e flamurit dhe hartën e Kosovës, futbollistët "dardanë" do të jenë më të motivuar dhe do të ndiejnë edhe më shumë përgjegjësi ndaj vendit të tyre. Linja e re e veshjeve prezanton tri dizajne të fanellave: me të kaltrën "Dardanët" do të luajnë në shtëpi, me të bardhën në udhëtim, ndërsa ngjyra e zezë është përzgjedhur si opsion i tretë. Me dizajn të ri, material cilësor dhe komoditet, fanellat dhe pajisjet e reja sportive plotësojnë standardet më të larta të veshjeve sportive, po ashtu ofrojnë rehati gjatë



stërvitjeve dhe ndeshjeve. Njëpërmjet këtij bashkëpunimi trevjeçar të FFK-së me partnerin e UEFA-s "Errea", ekipet përfaqësuese të të dy konkurrencave do të pajisen me

të gjitha uniformat dhe pajisjet e nevojshme sportive. "Urojmë që fanellat e reja të sjellin fat dhe suksese për 'Dardanët' në ciklin kualifikues për 'Euro 2024', thuhet në postimin e FFK-së.

## Denveri e Milwaukee mbrojnë kreun në Konferencat përkatëse, avancojnë lakersat

Milwaukee, 23 mars - Skuadra kampione e Golden States mposhti me rezultat 127-125 rivalët e Dallasit, duke qëndruar në zonën "play-off" në Perëndim. Ndeshje e ekuilibruar deri në fund, ku për Warriorsin u dalluan Kuminga me 22 pikë e Curry me 20 pikë e 13 asistime. 30 pikët e Luka Donçiqit për Dallasin mbetën për statistikë. Fitore të rëndësishme arriti edhe ekipi i lakersave, që mundi me rezultat



122-111 Phoenixin. Devin Booker realizoi 33 pikë për miqtë, por që s'mjaftuan për të fituar. Për lakersat u dalluan Davisi me 27 pikë, Russell me 26 e Reaves me 25 pikë. Memphisi, falë 37 pikëve e 10 reboundeve të Jaren Jacksonit, mundi me shifrat 130-125 Houstonin (Green 32 pikë). Denveri konsolidoi pozitën në krye të renditjes në Perëndim pas

fitores me shifrat 118-104 ndaj Washingtonit. Nikola Jokiqi, protagonist me 31 pikë e 12 rebounde. Fitore të lehtë arriti Milwaukee, që mbron kreun në Lindje pas fitores me shifrat 130-94 ndaj San Antonios (Antetokounmpo 31 pikë e 14 rebounde), ndërsa Miami mundi 127-120 New York (Butler 35 pikë).

### REZULTATET

Washington - Denver	104-118
Dallas - Golden State	125-127
Miami - New York	127-120
Toronto - Indiana	114-118
Chicago - Philadelphia	91-116
Memphis - Houston	130-125
Milwaukee - San Antonio	130-94
Minnesota - Atlanta	125-124
Utah Jazz - Portland	115-127
Lakers - Phoenix	122-111

## Mediet spanjolle: Haalandi transferohet te Reali në vitin 2024

Erling Haaland vazhdon të jetë në qendër të medieve sportive prej performancës së tij fantastike me Manchester Cityn këtë sezon. Gjithsesi duket se ai nuk do të

qëndrojë te "qytetarët" për një kohë të gjatë. Të paktën kjo është ajo që raportojnë mediet spanjolle. Siç bën me dije gazeta "AS" në faqen e parë të saj,

sulmuesi norvegjez do të transferohet te Reali në vitin 2024. "Galaktikët" do të përpiqen të përfitojnë nga një klauzolë që e lejon norvegjezin të largohet nga

City verën e ardhshme, me presidentin Perez që e shikon atësi zëvendësuesin e duhur të Karim Benzemas. Ky transferim pritet që të bindë edhe Mbappenë që ta

zgjedhë Realin në të ardhmen, me sulmuesin francez që vazhdon të jetë në planet e Perezit, edhe pse vitin e kaluar ai zgjodhi të qëndrojë te PSG-ja.

### SHKURT

#### Besa Famgas e Rahoveci kalojnë në gjysmëfinale

Nuk ka pasur befasi të mërkurën në dy ndeshjet e para çerekfinale të Kupës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Fituesja në fuqi e Kupës, Besa Famgas, ka kaluar Kastriotin në çerekfinale, duke e mposhtur në Ferizaj me rezultat 41:31. Arditi Tafilaj i shënoi shtatë gola për Besën, ndërsa nga gjashtë Egzon Gjuka, Arbios Mushkolaj e Amar Korkariq. 11 gola për Kastriotin i shënoi Hamdi Salihu, ndërsa gjashtë Festim Mustafa. Rahoveci e ka mposhtur Deçanin me rezultat 35:22. Marley Wallace Fernandes i shënoi dhjetë gola për Rahovecin, kurse nga pesë i kishin Alban Haziri e Mali Luzha. Fatlind Mazrekaj i shënoi nëntë gola për Deçanin.

#### Muja dikur vlen 250 mijë euro, sot 1.5 milion euro

Arbnor Muja po shkëlqen në skuadrën belge Royal Antwerp, ku edhe ka marrë ftesë nga Përfaqësuesja A e Kosovës për dy ndeshjet e muajit mars. Vlera e ish-futbollistit të Trepçës '89 dhe Dritës është ngritur në 1.5 milion euro nga "Transfermarkt". Kjo është vlera më e madhe që ka pasur Muja ndonjëherë, pasi tetë muaj më parë sa ishte te Drita vlen vetëm 250 mijë euro. 24-vjeçari ka luajtur 22 ndeshje me Antwerpen duke realizuar tre gola e duke asistuar në katër të tjerë. Sigurisht që vlera e rritur e Mujës gëzon edhe Dritën që ka ruajtur 20 për qind të kartonit nga shitja e ardhshme.

#### Projektohet rikthimi i Messit te Barcelona

Lionel Messi është bashkuar me Argjentinën, një vend ku ndihet ende "mbret", ndryshe nga Parisi ku tifozët nuk ngurojnë as ta vërshëllojnë. Situata që "pleshti" po përjeton këtë periudhë te PSG-ja ka bërë që kampioni i botës të stepet në lidhje me të ardhmen. Pak muaj më parë rinovimi dukej një formalitet, por situata ka ndryshuar shumë kohët e fundit duke bërë që Messi më shumë të jetë larg Parisit në fund të këtij sezoni. Messi do të largohej falas pasi i përfundon kontrata, ndërsa në Spanjë vijojnë të besojnë se ylli argjentinës mund të rikthehet sërisht te Barcelona. "Operacioni Messi", shkruan "Mundo Deportivo" në faqen e parë. E përditshmja pranë klubit blaugrana ka zbuluar se çelësi për të arritur te Messi është dhënia e një roli në klub pasi ta ketë mbyllur me futbollin e luajtur. Kjo formulë mund të bindë Messin të rikthehet në "Camp Nou".

#### Pesë lojtarë largohen nga grumbullimi i Holandës për shkak të virusit

Holanda ka humbur pesë lojtarë për shkak të një infeksioni viral në skuadër përpara ndeshjes së saj kualifikuese për "Euro 2024" kundër Francës në Paris të premten. Mbrojtësit Matthijs de Ligt dhe Sven Botman, sulmuesi Cody Gakpo, mesfushori Joey Veerman dhe portieri Bart Verbruggen janë dërguar të gjithë në shtëpi nga trajneri Ronald Koeman, ka njoftuar të enjten federata holandeze. Koeman ka thirrur qendërmbrojtësin e Interit, Stefan de Vrij, mesfushorin e Bayern Munchen, Ryan Gravenberch dhe portierin e Vitesse Arnhem, Kjell Scherpen, si zëvendësues. Holanda përball me Francën përpara se ta presë Gjibraltarin në ndeshjen e dytë kualifikuese të Grupit B të hënën.



Kompania Rajonale e Mbeturinave  
Regjionale e Mbeturinave, 22 Ullashanjski Ujvada  
"PASTRIMI" sh.a. d.d.  
Nr. br. 312 dt. 23.03.2023  
Prishtinë - Prishtina



Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (nenit 21 parag.21.1), Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike (neni13), si dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi" SH.A, Prishtinë, më datë 23.03.2023 mori vendim që të rishpallë:

### KONKURS

**Pozita e punës: Sekretar /e - i/e Bordit të Drejtorëve /Këshilltar/e - i Përgjithëm**

**Kohëzgjatja e kontratës: 3 (tre) vite**

**Vendi : Prishtinë**

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Mirëmbanë regjistrin e aksionarëve të Ndërmarrjes;
- Vepron si agent i Ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve;
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe /ose zbulimet për autoritetet përkatëse siç kërkohet me ligj dhe aktet nënligjore;
- Kordinon me KE-në përgatitjen e shkresave (dokumente) për mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe shënon ato në librat e protokoleve;
- Pranon dhe distributon shkresat për Bordin e Drejtorëve;
- Ofron udhëzime juridike për Bordin e Drejtorëve;
- Kryen edhe punë tjera të kësaj fushe në bazë të kërkesës së Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes;
- I raporton Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes

#### Përgatitja profesionale dhe Kualifikimi:

- Të posedojë diplomë universitare në ligj dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Njohuri të ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi dhe njohuri në programet operative Microsoft Office, (Word, Exel, Outlook, etj).

#### Informata të përgjithshme:

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data 23.03.2023 deri me datë 07.04.2023 si datë e mbylljes së konkursit. Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A., Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Në rast nevojë për informacione shtesë mund të na kontaktoni në, tel: 038/603-191 prej orës 08:00 – 15:00.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

#### Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentacioni i kërkuar:

- CV (Biografinë);
- Deklarata nën betim (e cila do të merret në kopje fizike në ndërmarrje);
- Diplomen e fakultetit (kopje);
- Dëshmin mbi përvojën e punës apo trustin pensional;
- Kopjen e leternjoftimit (apo pasaportës);
- Certifikata mbi denimet penale (jo më e vjetër se 6 muaj).

Kompania Rajonale e Mbeturinave  
Regjionale e Mbeturinave, 22 Ullashanjski Ujvada  
"PASTRIMI" sh.a. d.d.  
Nr. br. 312 dt. 23.03.2023  
Prishtinë - Prishtina



Na osnovu Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima (član 21 stav 21.1), Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-87 o javnim preduzećima (član 13), kao i kao Administrativnog uputstva (MPMS) br. 07/2017 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, Upravni odbor KRM „Pastrimi“ dd, Prishtina, je 23.02.2023. godine odlučio da ponovo objavi:

### KONKURS

**Radno mesto: Sekretar Upravnog odbora / Generalni savetnik**

**Trajanje ugovora: 3 (tri) godine**

**Mesto: Priština**

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Vodi registar akcionara Preduzeća;
- Deluje kao agent Preduzeća za prijem obaveštenja;
- Podnošenje svih podnesaka, publikacija i/ili obelodanjivanja relevantnim organima u skladu sa zakonom i podzakonskim aktima;
- Koordinira sa EK pripremu sažetaka i (dokumenata) Odbora direktora i Komisije za reviziju (osim ako njihov predsedavajući ne zahteva drugačije), i beleži ih u knjigama protokola;
- Prihvata i distribuira pisma Upravnom odboru;
- Pruža pravne smernice Upravnom odboru;
- obavlja i druge poslove u ovoj oblasti na osnovu zahteva Upravnog odbora i glavnog izvršnog direktora Preduzeća;
- Izveštaji Upravnom odboru i Glavnom izvršnom direktoru preduzeća

#### Stručna priprema i kvalifikacija:

- Da poseduje univerzitetsku diplomu pravnika i značajno profesionalno iskustvo u oblasti korporativnog upravljanja ili prava kompanija;
- Poznavanje važećih zakona i podzakonskih akata;
- Veštine komunikacije, planiranja rada i vođenja tima;
- Veština i poznavanje operativnih programa Microsoft Office (Word, Ekcel, Outlook, itd.).

#### Opšte informacije:

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počev od 23.03.2023. do 07.04.2022. godine kao datuma zatvaranja konkursa. Očrazac prijave se prima i dostavlja u zatvorenoj koverti u arhivu KRM „Pastrimi“ SH, ul. „Tahir Zajmi“, br. 5, Priština.

Prijava putem pošte: Prijava sa dokumentima se može dostaviti i poštom na adresu: Ul. „Tahir Zajmi“, br.5, Priština, 10000. Prijave poslate poštom mcrāju imati poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu. Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig o dostavi izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i smatraće se, ako stignu u roku od 3 tri dana, prijave koje stignu nakon ovog roka, a nepotpune će uopšte ne uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor. U slučaju potrebe za dodatnim informacijama, možete nas kontaktirati na, tel: 038/603-191 od 08:00 - 15:00 časova.

#### Uslovi učesća na konkursu:

Svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, imaju neophodnu obrazovnu spremu i profesionalnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti i koji imaju pravo da konkurišu imaju pravo da se prijave. fizičke veštine potrebne za odgovarajuću poziciju.

KRM "Pastrimi" dd nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja prijave svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

#### Uz prijavu je potrebno priložiti potrebnu dokumentaciju:

- CV (biografija);
- Izjava pod zakletvom (koja će se dobiti u fizičkoj kopiji u preduzeću);
- Fakultetska diploma (kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu ili penzionom fondu;
- Kopija obaveštenja (ili pasoša);
- Uvjerenje o osuđivanosti (ne starije od 6 meseci).



**Thirrje për Aplikim**Kompania: **EMIR TAÇI B.I**

NRUI: 812016609

Adresa: Rruga Cumhuriyet 11, pn Mamushë

Kërkon ofërtues/kompani të interesuar dhe të kualifikuar-Licensuar që të dorëzoj ofertë për projektin me titull:

*Ndërtimin e serrës së re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m<sup>2</sup>) me profile të zinguarra komplet.*

Investimi në *Ndërtimin e serrës se re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m<sup>2</sup>) me profile të zinguarra komplet*, do të bëhet në adresën: Rruga Cumhuriyet 11, pn Mamushë.

Kompanit e interesuar mund të kontaktojnë në email: [emirtac78@gmail.com](mailto:emirtac78@gmail.com) ose përmes formës fizike me zarf dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur dhe duhet të bëhet me se largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes. Ndërsa, afati kohor për marrjen e ofertave është të paktën dhjetë (10) ditë, gjithësej pësembedhjet (15) ditë janë procedurat e prokurimit.

Kompanit e interesuar, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët.

**Për çdo sqarim dhe info kontaktoni në numrin:**

**+383- 044-347-362**

**Thirrje për Aplikim**Kompania: **ARTAN MAZREK B.I**

NRUI: 812015247

Adresa: Rruga Cumhuriyet, pn Mamushë

Kërkon ofërtues/kompani të interesuar dhe të kualifikuar-Licensuar që të dorëzoj ofertë për projektin me titull:

*Ndërtimin e serrës së re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m<sup>2</sup>) me profile të zinguarra komplet.*

Investimi në *Ndërtimin e serrës se re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m<sup>2</sup>) me profile të zinguarra komplet*, do të bëhet në adresën: Rruga Cumhuriyet, pn Mamushë.

Kompanit e interesuar mund të kontaktojnë në email: [dasa-mamusa@hotmail.com](mailto:dasa-mamusa@hotmail.com) ose përmes formës fizike me zarf dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur dhe duhet të bëhet me se largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes. Ndërsa, afati kohor për marrjen e ofertave është të paktën dhjetë (10) ditë, gjithësej pësembedhjet (15) ditë janë procedurat e prokurimit.

Kompanit e interesuar, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët.

**Për çdo sqarim dhe info kontaktoni në numrin:**

**+383- 044-695-698**

**Thirrje për Aplikim**Kompania: **EMRE ŞALA B.I**

NRUI: 812015172

Adresa: Rruga Cumhuriyet, pn Mamushë

Kërkon ofërtues/kompani të interesuar dhe të kualifikuar-Licensuar që të dorëzoj ofertë për projektin me titull:

*Ndërtimin e serrës së re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m<sup>2</sup>) me profile të zinguarra komplet.*

Investimi në *Ndërtimin e serrës se re me sipërfaqe prej 0.40 ha (4000 m<sup>2</sup>) me profile të zinguarra komplet*, do të bëhet në adresën: Rruga Cumhuriyet, pn Mamushë.

Kompanit e interesuar mund të kontaktojnë në email: [salazeynel@gmail.com](mailto:salazeynel@gmail.com) ose përmes formës fizike me zarf dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur dhe duhet të bëhet me se largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes. Ndërsa, afati kohor për marrjen e ofertave është të paktën dhjetë (10) ditë, gjithësej pësembedhjet (15) ditë janë procedurat e prokurimit.

Kompanit e interesuar, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët.

**Për çdo sqarim dhe info kontaktoni në numrin:**

**+383-044-254/499**

**Thirrje për Aplikim**Kompania: **CANSER SALA B.I**

NRUI: 810044420

Adresa: Lale Sokak, p.n Mamushë

Kërkon ofërtues/kompani të interesuar dhe të kualifikuar-Licensuar që të dorëzoj ofertë për projektin me titull:

**NDËRTIMI I DEPOS PËR RUAJTJEN E PËRIMEVE ME SIPËRFAQE PREJ 405 m<sup>2</sup>.**

Investimi në *Ndërtimin e depos për rruajtjen e perimeve me sipërfaqe prej 405 m<sup>2</sup> me sendwiq panell*, do të bëhet në adresën: Lale Sokak, p.n Mamushë.

Kompanit e interesuar mund të kontaktojnë në email: [salazeynel@hotmail.com](mailto:salazeynel@hotmail.com) ose përmes formës fizike me zarf dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur dhe duhet të bëhet me se largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes. Ndërsa, afati kohor për marrjen e ofertave është të paktën dhjetë (10) ditë, gjithësej pësembedhjet (15) ditë janë procedurat e prokurimit.

Kompanit e interesuar, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët.

**Për çdo sqarim dhe info kontaktoni në numrin:**

**+383-044-254/499**









# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

